



Analizë e politikave
Linja Ekspres Rahovec-Bruksel

25 nëntor 2009

Kjo analizë e politikave është përpiluar me përkrahjen dhe iniciativën zemërgjerë të
Fondacionit Kosovitar për Shoqëri të Hapur

Copyright © IKS, 2009

Linja Ekspres Rahovec-Bruksel

Përmbajtja

HYRJE	1
MIRËSEVINI NË RAHOVEC	3
PRODHIMI I VERËS NË RAHOVEC	4
Vendi i rrushit	5
Pasion për verë apo mjet për mbijetesë	10
Gjasat reale për rritje	12
Drejt Evropës e më pas drejt botës	14
NË RRUGË PËR BRUKSEL	16
Gjendja në terren	20
Çka jam duke pirë dhe prej nga është	21
Ku është Kosova?	23
GROPAT NË RRUGËN PËR NË BRUKSEL	24
Thirrje për të gjithë investitorët	25
Po gjendja me femrat dhe verën?	26
LINJA EKSPRES RAHOVEC – BRUKSEL: UDHËRRËFYESI	28

HYRJE

Procesi i “statusit final” të Kosovës ia hapi rrugën vendit drejt integritimit evropian në të ardhmen. Pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008, Qeveria e Kosovës u përball me një rrebesh problemesh ekonomike dhe sociale të cilat ishin vënë në pritje për së paku një dekadë. Një ndër sfidat më të mëdha ishte identifikimi i mënyrave për krijimin e mundësive të reja të punësimit, të cilat do të gjeneronin rritje ekonomike të qëndrueshme.

Ngushtë e ndërlidhur me këtë është pyetja e nxehtë mbi “fatin evropian” të Kosovës. Përtej retorikës së evropianizimit, duhet shtjelluar se cilat do të jenë kushtet konkrete politike të cilat do të bëjnë që Kosova të jetë e gatshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). Organizatat ndërkombëtare dhe institucionet përkatëse kanë filluar të ndërmarrin hapa për zhvillimin e politikave drejt integritimit në BE. Por rrallë herë është diskutuar shkalla në të cilën vendimet politike të ndërmarra në nivel qendror sjellin zhvillime pozitive në fshatrat e Kosovës dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve rural.¹ Megjithatë, ekzistojnë arsye shtesë të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë në Kosovë pavarësisht faktit që Kosova duhet të punojë drejt përmbushjes së kërkesave të detajuara në bazë të *Acquis Communautaire*, si parakushte për anëtarësim në BE, me bujqësinë që bie në mes të kaptinave më të rrepta dhe sfiduese të rregulluara me *acquis*.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) mund të ketë qenë ministria më së paku e financuar në vitet 2008 dhe 2009,² por mos lejoni që ky fakt t’ju mashtrtojë. Bujqësia është sektor *vital* i Kosovës. Supozohet që 60 përqind e popullatës së Kosovës jeton në zona rurale,³ ndërsa Enti Statistikor i Kosovës ka raportuar se bujqësia është “dega më e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës,” ngase përbënte 16.9 përqind të veprimtarisë ekonomike në vitin 2007.⁴ Për më tepër, përkundër përkrahjes së dobët qeveritare për këtë sektor dhe klimës së pafavorshme ligjore që paraqet pengesë shtesë për fermerët,⁵ bujqësia përbën afërsisht 30 përqind të GDP-së së Kosovës.⁶ Sot bujqësia është *punëdhënësi më i madh në Kosovë*, meqenëse punëson afërsisht 145,000 individë, krahasuar me vetëm 85,000 individë që punësohen në sektorin privat jobujqësor.⁷

Identifikimi i mundësive për forcimin e sektorit të bujqësisë do të mundësojë trajtimin e disa problemeve sociale me të cilat përballlet Kosova. Varfëria, analfabetizmi, nivelet e ulëta të

¹ IKS ka realizuar një hulumtim mbi decentralizimin dhe ndikimin e tij të deritanishëm në nivelin komunal (pritet në fillim të vitit 2010). Gjatë konferencës “Çështjet gjinore dhe identiteti” të organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, në mars të vitit 2009 në Prishtinë, pjesëmarrësit gjithashtu theksuan nevojën për të identifikuar ndikimin e politikave kombëtare në komunitetet rurale dhe në veçanti tek gratë.

² Tabelat Buxhetore për vitin 2009, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Republika e Kosovës.

³ MBPZHR, “Libri i Gjellbër i Kosovës: Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm Bujqësor dhe Rural në Kosovë”, Prishtinë, maj 2004, faqe 8.

⁴ Bujqësia është gjithashtu sektori i dytë për nga madhësia sa i përket punësimit të grave, duke bartur 19.3 përqind të vendeve të punës (i dyti pas sektorit të arsimit që punëson 20.2 përqind). Statistikat e Tregut të Punës, ESK, Prishtinë, 2008, faqe 18, i gjendur më 27 maj të vitit 2009 në adresën <http://www.ks-gov.net/ESK/eng/dmdocuments/Labour%20Market%20Statistics%202007.pdf>.

⁵ Shih faktet në kaptinat në vijim.

⁶ MBPZHR, “Libri i Gjellbër i Kosovës: Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm Bujqësor dhe Rural në Kosovë”, Prishtinë, maj 2003, faqe 8.

⁷ MASHT, MBPZHR, FAO “Strategjia për Arsimitin e Popullatës Rurale në Kosovë”, faqe 24.

arsimimit (në veçanti tek vajzat),⁸ pamundësia e qasjes në sistemin shëndetësor,⁹ dhe dhuna në familje¹⁰ janë vetëm disa nga çështjet që joproportionalisht ngarkojnë popullatën në zonat rurale. Identifikimi i strategjive të qarta për zhvillimin e bujqësisë dhe përmirësimin e statusit ekonomik të tyre rrjedhimisht mund të kontribuojë drejt arritjes së Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM), implementimit të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE),¹¹ dhe shumë planeve tjera qeveritare të veprimit.¹²

Përmes këtij hulumtimi, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) ka mëtuar t'i trajtojë disa nga këto sfida, duke shtjelluar për më së afërmi ekonominë rurale të një njësie: Rahovecit.¹³ Komuna e Rahovecit, me të kaluarën e vet të pasur në prodhim të verës dhe me tokën e vet bujqësore pjellore, ka potencial të theksuar për zhvillim në të ardhmen. Kjo komunë gjithashtu ka shënuar përparim pas përfundimit të procesit të privatizimit, ndërsa që disa nga komunat fqinje të saj, si Gjakova e Prizreni, kanë dështuar në këtë drejtim. Mësimet e nxjerra në Rahovec mund të shfrytëzohen si zgjidhje për ato degë të industrisë së verës që aktualisht kanë ngecur.

Edhe pse industria e verërave përbën vetëm një pjesë të vogël të sektorit bujqësor të Kosovës, ajo gëzon potencial të madh për qasje në tregjet evropiane, në të cilat kërkesa për verëra të importuara është e madhe. Në aspektin kulturor, si simbol i zhvillimit dhe progresit, profesionalizimi i industrisë së verërave gjithashtu mund të përmirësojë imazhin e jashtëm të Kosovës. Si analizë e politikave, “Linja Ekspres Rahovec-Bruksel” paraqet alternativa praktike të politikave drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, si pjesë e “udhërrëfyesit” të evropianizimit të Kosovës. Pra, të ngremë një doli: për Brukselin, na prit se erdhëm!

⁸ Derisa gratë në zonat urbane kanë të përfunduara mesatarisht nëntë vjet shkollim, ato në zonat rurale kanë rreth shtatë sish. Por të dyja këto grupe janë të shkolluara më dobët se sa meshkujt (ESK, Femrat dhe Meshkujt në Kosovë, Prishtinë: ESK, mars 2009 faqe 35). Për të mësuar më shumë për arsyet e mospasjes së qasjes në shkolla për fëmijët në viset rurale, në veçanti për vajzat, shih raportin e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) *Siguria fillon në shtëpi*, Prishtinë: Agjencia për Barazi Gjinore 2008.

⁹ Ndërsa ka pak të dhëna zyrtare lidhur me qasjen në shëndetësi, disa studime kualitative kanë theksuar këtë problem, posaçërisht për gratë që nuk kanë kontroll mbi burimet familjare. Shih për shembull dokumentin e RRGK-së *Siguria fillon në shtëpi: hulumtim përshkrues mbi shkallën e dhunës në baza gjinore në Kosovë dhe ndikimin e saj në shëndetin riprodhues të grave*, Prishtinë: RRGK, mars 2008; dhe Monitorimi i implementimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, botimi i dytë, Prishtinë: RRGK, 2009.

¹⁰ Gratë dhe vajzat që jetojnë në zonat rurale janë më së shumti të rrezikuara nga dhuna në familje (shih RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*).

¹¹ Disa prioritetet e PVPE-së ndërliken me zhvillimin bujqësor dhe përmirësimin e kushteve në veçanti për gratë rurale. Veprimi 39.6 kërkon nga Qeveria të “rrisë numrin e grave ndërmarrëse përmes sigurimit të mundësive për qasje më të mirë ndaj pronave, kapitalit dhe huave, përmes programeve për hua për gratë dhe specifikisht për hua speciale për gratë rurale.”

¹² Për shembull, Objektivi 4.1 e “Strategjisë dhe planit të veprimit për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës (2009-2011)” kërkon që të sigurohet qasje e barabartë ndaj arsimimit cilësor, përfshirë edhe për vajzat nga zonat rurale.

¹³ Në mungesë të të dhënave të gatshme dhe të besueshme, IKS kreu një studim të detajuar të komunës së Rahovecit. IKS përdori metodologjitë hulumtuese të sajura dhe aplikuara me sukses nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI), e cila kombinon studimet e rasteve me hulumtim analitik të detajuar për të arritur deri te avokimi politik. Në rastin e studimit janë shqyrtuar legjislacioni ekzistues, literatura dhe të dhënat statistikore në dispozicion si dhe përcaktimi i gjendjes ekonomike në Rahovec, duke u bazuar në intervistat e pastrukturuara me pjesëtarë të ndryshëm të komunitetit. Me rastin e studimit testohen dhe verifikohen të dhënat ekzistuese dhe i njëjti mundëson identifikimin e trendeve të caktuara ekonomike dhe sociale në këtë komunë.

MIRËSEVINI NË RAHOVEC

Në jugperëndim të Kosovës, e kufizuar me komunat e Gjakovës, Klinës, Suharekës dhe Prizrenit, shtrihet komuna e Rahovecit. Udhëtimi drejt qendrës së Rahovecit ia vlen mundin. Gjatë zbritjes pranë luginës vërehen fshatrat e vendosura në krahë të kodrinave, ndërsa gjendesh i rrethuar nga kodrat e Drenicës në verilindje dhe Alpet shqiptare në drejtim të kufirit me Shqipërinë në jugperëndim. Kjo tokë pjellore, mes qyteteve më të mëdha të Gjakovës dhe Prizrenit, përfiton një nga sistemet më të vjetra të ujitjes në Kosovë, që rrjedh përkrah lumit të Drinit. Rahoveci paraqet bazën e prodhimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë. Gjatë udhëtimit, me rritjen e lartësisë mbidetare vërehet tokë më e thatë. Në këto pjesë, fushat e gjelbra zbulojnë të vendosura rend mbi rend vreshtat e shumta. Në fakt, Rahoveci është komunë kryesisht bujqësore, ngase afro dy të tretat e 73,000 banorëve të kësaj komune jetojnë në 35 fshatrat e saj.

Në disa vende peizazhi bujqësor ndërpritet dhe paraqiten ndërtesa të porsandërtuara, shtëpi private të reja dhe ish-ndërmarrje shoqërore (NSh) rishtas të privatizuara, të cilat për shumë rahovecas paraqesin shpresë të re për një të ardhme ekonomikisht të qëndrueshme. “Të gjitha ndërmarrjet e privatizuara në Rahovec paraqesin ndryshim pozitiv për këtë rajon, por edhe shpresë të madhe për popullatën e këtij rajoni,” komentoi Rexhep Pista, pronar i NSh-së së privatizuar *Ekoplast*. “Para privatizimit gjërat lëviznin mbrapshtë...gjatë privatizimit ato nuk lëviznin fare...ndërsa tani ato po lëvizin përpara, dhe kjo paraqet një shenjë shumë të mirë.”

Në vitin 2008, procesi i privatizimit pothuajse përfundoi. Gjashtë nga shtatë NSh-të në Rahovec u privatizuan. E para ndërmarrje e tillë ishte *OSA Termosistemi*, një kompani për prodhimin e pajisjeve ftohëse për përdorim komercial dhe këmbim të nxehtësisë. Ish NSh *Spektri 18 Nëntori*, me fabrikën e saj të plastikës, fabrikën e baterive dhe deponë, u privatizua më pas në vitin 2005. Ish-NSh *Ekoplast* (tani e emërtuar NTP *Pista*) u privatizua në vitin 2006, dhe është aktive në riciklimin dhe prodhimin e plastikës. Po në këtë vit, bodrumi i vjetër NBI *Rahoveci* (tani i emërtuar *Bodrumi i Vjetër Haxhijaha*) u privatizua krahas njësisë së ndërtimit, që atëbotë ishte pjesë e NSh-së *1 Maji*. NTS *Podrima* mbeti ndërmarrja e vetme e paprivatizuar. Gjatë viteve të 80-ta, NSh-të në Rahovec punësonin rreth 2,915 individë. Tani, pas privatizimit, në vitin 2007 norma e punësimit nga to ishte për 60 përqind më e ulët; gjashtë ndërmarrjet e privatizuara punësonin 909 punëtorë.

Megjithatë, shumica e rahovecasve i varin shpresat për të ardhmen në dy ndërmarrjet më të mëdha të privatizuara: mullirin e miellit *M&Sillosi* dhe prodhuesin e verërave NBI *Rahoveci*, që tani njihet si veraria *Stone Castle*. Të privatizuara në vitin 2006 me ndërtesa, teknologji dhe pajisje të reja, këto kompani janë punëdhënësit më të mëdhenj në regjion. Këta dy gjigandë, të mbetur nga epoka socialiste, punësonin 69 përqind të numrit të gjithmbarshëm të punësuarve nga të gjitha ndërmarrjet e privatizuara në këtë rajon: *M&Sillosi* me 367 punëtorë dhe *Stone Castle* me 257 sish. Ato u privatizuan me “*spin-of special*” apo përmes një marrëveshjeje, sipas të cilës

pronarët duhet të përmbushin obligimet e tyre për të investuar €24,887,564¹⁴ në të dyja kompanitë, dhe për të punësuar gjithsej 608 punëtorë në to.¹⁵ Në vitin 2007, ato kishin tejkaluar zotimet e dhëna dhe të dyja punësonin gjithsej 624 punëtorë. Edhe pse pas luftës është shënuar përparim, këtyre ndërmarrjeve iu mbetet ende shumë për të bërë për të arritur numrin e të punësuarve që kishin gjatë të tetëdhjetave: 1,750.

Punësimi në sektorin publik ofron pak vende pune. Vetëm 1,130 individë në komunën e Rahovecit kanë marrë paga nga Qeveria e Kosovës në vitin 2009.¹⁶ Pothuajse 75 përqind e këtyre pozitave janë në sektorin e arsimit. Qyteti i Rahovecit nuk ofron më shumë se një rrugë të gjatë që përshkohet me disa shitore dhe kafene të vogla nga të dyja anët.

Duke qenë se sektori publik nuk ofron shumë vende pune dhe që në këtë komunë ka pak biznese të vogla, shumica e tyre aktive në sektorin e shërbimeve, bujqësia mbetet mënyra më e arsyeshme për banorët e këtij regjioni për të siguruar jetesën. Supozohet se 57,151 rahovecas jetojnë nga bujqësia.¹⁷ Në logon e komunës së Rahovecit paraqitet një kështjellë dhe një vreshtë, ndërsa dita e rrushit është bërë festë vjetore në këtë komunë. Çdo 7 shtator fermerët ekspozojnë produktet e tyre të rrushit para ekspertëve, blerësve të mundshëm dhe përfaqësuesve institucionalë të cilët inspektojnë cilësinë dhe provojnë mostrat. Prodhuesit lokalë të verës kanë shpresë se do të rimarrin një pjesë të madhe të tregjeve evropiane të cilat i kanë humbur nga koha e ish-Jugosllavisë, kohë kjo kur jeta ishte e pasur dhe e plotë. Në fakt, për shumë qytetarë të Rahovecit vreshtat janë element që ua kujton atyre suksesin që kishin në kohën e Jugosllavisë, si dhe paraqesin simbol shprese për të ardhmen ekonomike të rajonit si aktor kyç në tregjet evropiane.

PRODHIMI I VERËS NË RAHOVEC

Duke u vërtitur rreth rafteve të verërave në një shitore të lagjes në Prishtinë, në kryeqytetin e Kosovës me rreth 300,000¹⁸ banorë, nuk mund të mos vërehen shumë etiketa që bartin emrin “Rahoveci.” Njëkohësisht, mund të vërehen vetëm pak etiketa nga rajonet konkurruese sa i përket verës, të cilat vijnë kryesisht nga Mali i Zi, Maqedonia dhe Italia. Në rafte gjenden të mbetura edhe disa shishe të pluhurosura të verës nga Gjakova dhe Krusha e Vogël, mbetje këto nga vitet para të nëntëdhjetave kur prodhimtaria atje lulëzonte. Çka e bëri Rahovecin rajonin më të suksesshëm të prodhimitarisë së verës në periudhën e pasluftës kundrejt konkurrencës? Mbase përgjigja gjendet në historinë e gjatë të këtij rajoni në prodhimin e verërave.

¹⁴ Sipas marrëveshjes me “spin-off special,” Stone Castle duhet të investojë €5,000,000 ndërsa M&Silosi €19,887,564.

¹⁵ Sipas marrëveshjes, Stone Castle duhet të ketë 250 punëtorë ndërsa M&Silosi 358.

¹⁶ Intervista e IKS me Dervish Çadrakun, Drejtor i Drejtorisë së Administratës, Rahovec, 15 prill 2009.

¹⁷ ESK, Anketim i Amvisërive Bujqësore 2005, Prishtinë: ESK, gusht 2006, faqe 16.

¹⁸ Dokument diskutimi i IKS: *Vizioni utopik*, Prishtinë, 2006.

Vendi i rrushit

Bujqësia dhe kultivimi i verërave në veçanti kanë një histori të gjatë në Rahovec. Shenjat e para të prodhimit të rrushit mund të gjenden në fshatin Reti.¹⁹ Atje mbi varrin e një ushtari antik janë të gdhendura pamjet e rrushit dhe një gotë vere.²⁰ Një artëfakt tjetër i lashtë nga ky rajon është një vorbë 400-litërshe e quajtur “*Tumba e Hamzageve*,” tani e ekspozuar në Teqenë Helvetica (një monument i vogël fetar) në qytetin e Rahovecit. Kjo vorbë dikur përdorej për verë, vaj ulliri dhe misër.

Dëshmi mbi vreshtat në Rahovecin e sotëm, që atëherë quhej zona e *Anadrinit*, janë të dokumentuara gjithashtu nga Pjetër Bogdani në vitin 1630. Megjithatë, kultivimi i përgjithshëm i rrushit të verës dhe prodhimi i verërave tkurret nën pushtimin e Perandorisë Osmane, ndërsa që kishin mbetur vetëm disa vreshta përreth kishave dhe manastireve.²¹ Lufta e Parë Ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore dëmtuan edhe më tepër vreshtarinë në Kosovë,²² si dhe sëmundja e bimëve (*Filoksera vastitriks*) që kishte kapluar Evropën, përfshirë edhe Kosovën, duke shkatërruar me qindra vreshta mes viteve 1913 dhe 1923.²³

Gjatë viteve 20 të shekullit XX, është bërë shumë punë për të ringjallur industrinë e verës në Kosovë. Në vitin 1920 është mbjellë fara e parë moderne në Rahovec, ndërsa varietetet amerikane fillimisht u përdorën në vitin 1923.²⁴ Në vitin 1939 vreshtat mbulonin më shumë se tremijë hektarë tokë në Kosovë.²⁵ Më pas, në vitin 1952, në komunën e Prizrenit u ndërtuan plantazhat dhe bodrumet e para moderne.²⁶ Rahoveci fitoi bodrumin e parë në vitin 1953, bodrum ky që sot është në pronë të kompanisë *Haxhijaha*.²⁷ Në vitin 1979, u ndërtua bodrumi i dytë si pjesë e NBI *Rahoveci* (tani njihet me emrin *Veraria Stone Castle*). Deri në vitin 1980, Rahoveci arriti të kishte sipërfaqen më të madhe të mbuluar me rrush sipas regjistrave kadastrale, me 1,063 hektarë si pronë shoqërore dhe 1,920 hektarë si pronë private të mbuluar me vreshta, duke përbërë 42 përqind të sipërfaqes së gjithmbarshme të vreshtave të Kosovës.²⁸ Industria e verës punësonte rreth 40 përqind të popullatës së Rahovecit.²⁹

¹⁹ Intervistë e IKS me Dr. Bashkim Korenica, Profesor në Fakultetin e Bujqësisë, 14 mars 2008.

²⁰ Edhe hulumtuesit jugosllavë Gavranqi dhe Vuksanoviç shkruan një publikim të quajtur “Fisi Ilir Darët kultivonin rrush shumë vite para ardhjes së romakëve në Ballkan” (studim nga Instituti i Pejës “*Gjendja e vreshtarisë – verëtarisë, Dje, Sot e Nesër – Perspektiva*”).

²¹ Intervistë e IKS me Nesim Morina, Shef i Institutit të Verës dhe Vreshtave në Rahovec, 28 mars 2008.

²² Edhe hulumtuesit jugosllavë Gavranqi dhe Vuksanoviç shkruan një publikim të quajtur “Fisi Ilir Darët kultivonin rrush shumë vite para ardhjes së romakëve në Ballkan” (studim nga Instituti i Pejës “*Gjendja e vreshtarisë – verëtarisë, Dje, Sot e Nesër – Perspektiva*”).

²³ IPVQ, MBPZHR, DPPP, Sektori i Hortikulturës, Njësia e Vreshtarisë, *Gjendja e vreshtarisë dhe verëtarisë në Kosovë, Historiku*, dokument pune nga Nesim Morina.

²⁴ *Ibid.*

²⁵ Intervistë me Nesim Morina, Shef i Institutit të Verës dhe Vreshtave në Rahovec.

²⁶ IPVQ, MBPZHR, DPPP, Sektori i Hortikulturës, Njësia e Vreshtarisë, *Gjendja e vreshtarisë dhe verëtarisë në Kosovë, Historiku*, dokument pune nga Nesim Morina.

²⁷ Intervistë e IKS me Hysen Canziba, ish-drejtori Verëtarisë NBI Rahoveci (tani Stone Castle), 1 shkurt 2008.

²⁸ Librat kadastrale të mbajtur nga Instituti i Pejës për vitet 1980/1981.

²⁹ Chris Hartwell për Ekipin e Projektit të Chemonics International për USAID mbi Organizimin dhe Përkrahjen e Bizneseve në Kosovë, publikimi “Gjendja e industrisë së verës në Kosovë,” korrik 2006, faqe 2.

Në epokën socialiste, industria jugosllave e verës kërkonte që përmes Kosovës të mbulojë tregjet masive të Evropës Perëndimore, duke gjeneruar kështu të ardhura në valuta të huaja.³⁰ Eksportet arritën pikën më të lartë të eksportit me litra në vitin 1985, duke eksportuar 35 milionë litra në Gjermani nga kompania *Racke*.³¹ Sipas Nesim Morinës, Shef i Institutit të Verës dhe Vreshtave në Rahovec “krenaria e tërë bujqësisë së Kosovës në vitet 1980 ishin vreshtat dhe sektori i verës së saj.” Ndërsa për sa i përket eksportit në masë, eksportet arritën kulmin më të lartë në vitin 1989 duke eksportuar 40 milionë litra në masë në Gjermani përmes transportit hekurudhor përmes kompanisë *Racke*.³²

Pas investimeve të bëra në këtë sektor, Kosova kishte rreth 9,000 hektarë vreshta në vitin 1990.³³

Fatkeqësisht, ngjashëm me NSh-të e tjera anembanë Kosovës, edhe fabrikat e Rahovecit pësuan rënie gjatë viteve 90, për shkak të situatës së përgjithshme politiko-ekonomike. Serbia gjendej nën embargo të tregtisë dhe nuk mund t’i shiste më produktet në tregun ndërkombëtar. Gjatë po këtyre viteve, katër fabrikat e mëdha në Gjakovë, Rahovec, Suharekë dhe Krushë të Vogël nuk ishin në gjendje të prodhojnë verëra me përfitime ekonomik.³⁴ Edhe në këtë gjendje, fermerët lokalë përpiqeshin t’i mbanin bizneset e tyre gjallë, duke organizuar simpoziumin e parë të llojit në Rahovec në vitin 1997 mbi temën “Vreshtat dhe Verërat e Kosovës.”³⁵

Pas një dekade nën-investimesh e pasuar nga shkatërrimet e luftës së vitit 1999, afro gjysma e zonës së kultivimit ishte e shkatërruar, ndërsa fabrikat e verës mezi funksiononin, nëse funksiononin. Në vitin 1990 ekzistonin 8,926 hektarë vreshta,³⁶ ndërsa në vitin 2001 kishin mbetur vetëm 3,447 sish.³⁷ Deri në vitin 2004, kjo sipërfaqe ishte rritur në 4,944 hektarë, nga të cilat afro 63 përqind ishin pronë private.³⁸ Sektori i verës ende nuk është rimëkëmbur plotësisht dhe zhvillohet kryesisht në formë të verërarive të organizuara familjare, që prodhojnë verëra në masë të vogël, kryesisht për tregjet rajonale.³⁹

Rivitalizimi i industrisë së verës filloi me procesin e privatizimit. Në vitin 2006, shqiptaro-amerikani nga Kosova, Harry Bajraktari u kthye në Kosovë për të blerë bodrumin e ri të NSh-së NBI Rahoveci së bashku me Rrustem Gecajn. Ishte NSh-ja e shitur më së shtrëngti në Rahovec, me çmim prej €4,302,900. Ata që atëherë e kanë transformuar atë në Vreshtat dhe Verëria Stone

³⁰ Intervistë e IKS me Afrim Kamishin, Zyrtar Projekti, WBDP në Swisscontact (Zyra në Gjakovë), 3 mars 2008.

³¹ Intervistë e IKS me Nesim Morinën, Shef i Institutit të Verëve dhe Vreshtave në Rahovec Institute, 28 mars 2008.

³² Chris Hartwell për Ekipin e Projektit të Chemonics International për USAID mbi Organizimin dhe Përkrahjen e Bizneseve në Kosovë, publikimi “Gjendja e industrisë së verës në Kosovë,” korrik 2006, faqe 2. dhe intervista e IKS me Nesim Morinën.

³³ IPVQ, MBPZHR, DPPP, Sektori i Hortikulturës, Njësia e Vreshtarisë, *Gjendja e vreshtarisë dhe verëtarisë në Kosovë, Historiku*, dokument pune nga Nesim Morina, faqe 2.

³⁴ Intervistë e IKS me Afrim Kamishin, Zyrtar Projekti, WBDP në Swisscontact (Zyra në Gjakovë), 3 mars 2008.

³⁵ Arkivi i ALBANEWS, korrik 1997, Prishtinë, qasur në maj 2008. Si udhëheqës në sektorin e verëve në Kosovë, Rahoveci shpesh është zgjedhur si lokacion i duhur për këtë eveniment.

³⁶ IPVQ, MBPZHR, DPPP, Sektori i Hortikulturës, Njësia e Vreshtarisë, *Gjendja e vreshtarisë dhe verëtarisë në Kosovë, Historiku*, dokument pune nga Nesim Morina, faqe 2.

³⁷ Departamenti për Prodhim dhe Mbrojtje të Bimëve, Drejtoria Komunale për Bujqësi.

³⁸ MBPZHR, “Libri i Gjellbër i Kosovës: Strategjia për zhvillim të qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë”, maj 2003, Prishtinë, Kosovë, faqe 31.

³⁹ Intervistë e IKS me Afrim Kamishin, Zyrtar Projekti, WBDP në Swisscontact (Zyra në Gjakovë), 3 mars 2008.

Castle. Pronarët kanë investuar katër milionë euro për të ngritur në këmbë kompaninë, duke iu afruar investimit të premtuar prej pesë milionësh. Ndërtesa administrative, vreshtat e reja, laborator i ri dhe njësitë e mbushjes janë disa prej përfitimeve nga investimet e deritanishme. Kompania është në rrugë të mirë për të ripërtërirë reputacionin e Rahovecit dhe për të ngritur imazhin e Kosovës në tregun evropian të verës.

Kompania ka investuar në marketing dhe ka vënë etiketa të reja në verërat e tyre duke shpresuar që t'i qaset tregjeve ndërkombëtare, në veçanti atyre të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara.⁴⁰ Stone Castle prodhon verëra nga rrushi Merlot, Chardonnay, Pinot, Game dhe nga lloje tjera. Gjithashtu kjo verëri është e vetmja në Kosovë që aktualisht kultivon rrushin Cabernet⁴¹ në vreshtat e veta.⁴²

Vreshtat dhe Veraria Stone Castle është një nga veraritë më të mëdha private në Evropë me kapacitet për të depozituar deri në 50 milionë litra në kontejnerë të pandryshkshëm të çelikut dhe pesë milionë litra në bure druri. Aktualisht, kapacitetet prodhuese të verarisë janë deri në shtatë milionë litra në vit. Kompania është e vendosur në një pronë prej 5.6 hektarësh në fshatin Bërnjakë dhe ka 513 hektarë vreshta aktive. Ajo punëson 257 punëtorë, me çka tejkalon premtimin e dhënë prej 250 punëtorësh në ofertën e tenderit të privatizimit, dhe planifikon të zgjerojë edhe më tej biznesin gjatë viteve në vijim.⁴³ Gjatë kohës së vjeljes numri i punëtorëve mund të ngrihet deri në 700 sish. Megjithatë, këto shifra duken më të zbehta kur krahasohen me afro 935 punonjës të punësuar në të në vitin 1982.⁴⁴ Shumica e punëtorëve janë veteranë të kësaj industrie dhe punojnë në të që nga ditët e socializmit dhe NBI Rahoveci.

Për shembull, Ibrahim Berisha, Shef i Njësive Punuese në Vreshta, ka punuar në verari që nga viti 1983.⁴⁵ Deri në vitin 1990, ish-NSh Rahoveci ka pasur mbi 1000 hektarë vreshta, teknologji të sofistikuar dhe kushte shumë të mira të punës, kujton ai. “Situata e gjithmbarshme ishte e mirë dhe sasia e prodhimit ishte më e lartë,” kujtohet ai. “Punëtorët kishin paga të larta (rreth 1000 marka gjermane) dhe paguheshin me rregull.” Edhe pse Stone Castle tani zotëron gjysmën e vreshtave aktive (513 hektarë), ai tha që ekziston mundësia për të mbuluar më shumë se 1000 hektarë me vreshta të reja. Veraria gjithashtu vazhdon të blejë rrush nga kultivues më të vegjël familjarë. Siç paraqitet në Tabelën 1, shumica e verarive të licencuara në Kosovë pjesën më të madhe të rrushit e blejnë nga fermerët lokalë, nga rreth 1,706.5 hektarë në vit. Rrjedhimisht, përveç punëtorëve që punësojnë, veraritë më të mëdha, siç është Stone Castle, përkrahin edhe shumë biznese më të vogla familjare që kultivojnë rrush në këtë zonë.

⁴⁰ Intervistë e IKS me Shani Hoxha, Menaxher i Shitjes, Stone Castle, 1 shkurt 2008.

⁴¹ Ky është një nga varietetet më të njohur të verës së kuqe në botë. Ai rritet në pothuajse të gjitha shtetet prodhuese të verës, dhe në një spektër të gjerë të kushteve klimatike, që nga Lugina Okanagan në Kanadë e deri në Luginën Beqaa në Liban.

⁴² Intervistë e IKS me Ibrahim Berisha, Shef i Njësive Punuese të Vreshtave, Veraria Stone Castle, 1 shkurt 2008.

⁴³ Intervistë e IKS me Ibrahim Berisha, Shef i Njësive Punuese të Vreshtave, Veraria Stone Castle, 1 shkurt 2008.

⁴⁴ Intervistë e IKS me Hysen Canziba, ish-drejtor i NBI Rahoveci, 1 shkurt 2008.

⁴⁵ Intervistë e IKS me Ibrahim Berisha, Shef i Njësive Punuese të Vreshtave, Veraria Stone Castle, 1 shkurt 2008.

Edhe pse Stone Castle është padyshim veraria më e madhe, edhe pesë verari tjera private janë të licencuara nga komuna e Rahovecit (shih Tabelën 1): *Bodrumi i Vjetër* (që prodhoi dy milionë litra verë në vitin 2007), *Eko* (75,000 litra), *Shpk. Rahoveci* (100,000 litra), *Rahvera* (15,000 litra), dhe *Biopak* (15,800 litra). Gjithsej, këto gjashtë verari prodhuan mbi dhjetë milionë litra verë në vitin 2007.

Tabela 1. Veraritë e licencuara në Rahovec

	Veraria	Pronari	Lokacioni	Vreshta aktive në pronë (ha)	Vreshta të furnitorëve (ha) ⁴⁶	Prodhim i verës në vitin 2007 (l)
1	Stone Castle	Harri Bajraktari & Rustem Gecaj ⁴⁷	Fshati Bërnjake	513.0	1143	7,000,000
2	Bodrumi i Vjetër (veraria Haxhijaha)	Halim, Ruzhdi, & Nevzat Haxhijaha	Rahovec	2.3	526	2,000,000
3	EKO	Bekim & Muje Hoxha	Rahovec	6.8	10	75,000
4	Shpk. Rahoveci	Ismet Vehapi	Rahovec	.5	26	100,000
5	Rahvera	Bajram Hajrullaga	Rahovec	2.5	0.5	15,000
6	Biopak	Nysret Haxhimurati	Rahovec	4.0	1	15,800
Totali				526.8	1,706.5	9,205,800

Veraria Haxhijaha, e njohur më mirë për nga emri i etiketës së saj “Bodrumi i Vjetër,” doli nga procesi i privatizimit të vitit 2006, si një nga komponentët e ish-NSh Rahoveci: Bodrumi i Vjetër u ndërtua në qendër të Rahovecit në vitin 1953, fillimisht si sektor i kombinatit të vjetër bujqësor “Kosova Vera.”⁴⁸ Sot Haxhijaha është biznes familjar i udhëhequr nga tre vëllezër. Pas privatizimit, bodrumi ishte në gjendje tejet të rëndë. Të gjitha pajisjet e mbetura funksionale datonin që nga vitet 50. Familja Haxhijaha investoi në teknologji të reja nga Franca dhe Italia duke i ngritur kësioj kapacitetet prodhuese në rreth pesë milionë litra, edhe pse veraria momentalisht prodhon vetëm rreth 30 deri 40 përqind të kapaciteteve të saj.

Përkundër praktikës së Stone Castle, Veraria Haxhijaha blen tërë rrushin, më se një milionë kilogram në vit, nga fermerët privatë. Që do të thotë, edhe pse kjo verari punësonte vetëm 16 punëtorë në vitin 2008, ajo përkrahte shumë familje të tjera nga kjo zonë që kultivojnë rrush. Në vitin 2006, veraria bleu më se një milion kilogramë rrush nga fermerët, përfshirë varietetet si Riesling të Rajnës, Riesling të Italisë, Chardonnay, Merlot, Vranac, Game, Pinot Noir, dhe Cabernet Sauvignon. Megjithatë, pronarët planifikojnë të blejnë dhe kultivojnë rreth 200 hektarë vreshta në të ardhmen e afërt.

Momentalisht, Veraria Haxhijaha shet verëra në shishe në të gjithë rrjetin e shitoreve të mëdha në Kosovë me etiketën “Bodrumi i Vjetër.” Për më tepër ajo eksporton në masë në Serbi dhe

⁴⁶ Kjo është kalkuluar nga IKS bazuar në numrat e dhënë në Master Plan. Shih shembullin e Bekim Hoxhës. Rendimentet e tij mund të jenë më të larta se të tjerëve.

⁴⁷ Intervistë e IKS me Ibrahim Berisha, Shef i Njësie Punuese të Vreshtave, Veraria Stone Castle, 1 shkurt 2008.

⁴⁸ Informatat mbi Verarinë Haxhijaha nga intervista e IKS me Halim Haxhijahën, bashkëpronar i verarisë Haxhijaha, 12 mars 2008.

Kroaci dhe është në proces të negocimit të kontratave për eksportim të verërave në shishe në Kroaci dhe Zvicër.

Familja e Bekim Hoxhës, prodhuesit e verës nën etiketën Eko, ka traditë të gjatë të kultivimit vreshtar. Më parë, familja kishte rreth 120 hektarë vreshta që ishin në pronë të tre vëllezërve: Avdyllit, Zeqirit dhe Avdiut. Në vitin 1969 familja e gjerë Hoxha u nda në njësi më të ngushta familjare dhe toka e tyre u nda në tri parcela. Me kalimin e kohës, familjet u shtuan dhe toka u nda prapë. Sot, familja e Bekim Hoxhës, nip i Avdyll Hoxhës, vazhdon të punojë në vreshta. Ai dhe dy vëllezërit e tij banojnë me familjet e tyre në një shtëpi në qytetin e Rahovecit.

Aktualisht familja ka 6.8 hektarë vreshta aktive nga të cilat nxjerrin rendiment prej rreth 45,400 kilogramë rrush në vit. Llojet e rrushit të kultivuar përfshijnë Riesling, Cabernet, Merlot, Prokupac, Game dhe Shiraz. Ata blejnë edhe afro 40,000 kilogramë rrush të llojeve të ndryshme nga fermerë tjerë privatë. Momentalisht, Eko ka katër punëtorë me orar të plotë pune dhe 21 punëtorë sezonalë. “Nuk është lehtë të punohet në prodhimin e verës” thoshte Bekimi. “Ndonjëherë të gjithë anëtarët e familjes duhet të rrinë nga 48 orë pa gjumë vetëm për të realizuar procesin e prodhimit të verës; vetëm shpirti jonë e di se sa vështirë është të punohet këtu.” Megjithëkëtë, ai citon një proverb kroat “Vera është shpirti, ushqimi është trupi,” duke sqaruar kështu se gjatë shtatorit me shumë obligime atij i bashkohen në verari edhe miqtë e tij për të konsumuar verë, mish dhe ushqim të mirë. “Kështu është më e lehtë të qëndrohet dhe punohet gjatë natës [të ndihmuar] nga magjia e verës,” shton ai.

Rrushi përpunohet në bodrumin e verës së familjes Hoxha, të vendosur në pjesën e prapme të shtëpisë së tyre, dhe rezulton me prodhimin e rreth 75,000 litrave verë në vit. Produkti final, verërat Eko, është i ekspozuar në një raft të bodrumit të tyre, krahas pamjeve nga pajisjet elektronike për mbushje dhe buret e shumta të drurit dhe metalit të të gjitha madhësive. Një bure e tillë me gota të verës pranë saj pret konsumatorët potencialë të cilët mund të ndalojnë për të inspektuar tërë këtë veprimtari dhe për të provuar verën.

Krahas investimeve prej rreth 300,000 marka gjermane (DM) nga familja Hoxha, krijimi i bodrumit në vitin 2002 është përkrahur teknikisht dhe financiarisht nga Swisscontacti me financim nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).⁴⁹ Në vitin 2003, familja kishte pranuar një grant në shumë prej €6,000 për të blerë pajisjet për prodhim të verës, siç janë rezervarët, buret dhe thyesit. Një grant tjetër prej €800 atyre iu dha për të blerë pajisjet laboratorike. Swisscontact kishte për qëllim që ta shndërrojë ndërmarrjen Eko nga një biznes familjar shtëpiak në një ndërmarrje të vogël të suksesshme.⁵⁰

Pas realizimit të investimeve zvicerane në pajisje dhe krijim të brendit, biznesi familjar i verarisë së Hoxhajve filloi të zhvillohet. Ky biznes zgjeroi linjën e prodhimit dhe filloi me marketing të verës së cilësisë së lartë, me etiketë Eko. Në vazhden e këtij suksesi Swisscontacti investoi edhe

⁴⁹ Intervistë e IKS me Afrim Kamishin, Zyrtar Projekti, WBDP në Swisscontact (Zyra në Gjakovë), 3 mars 2008.

⁵⁰ Ibid.

€3,000 në lansimin e një fushate reklamuese për Eko-n. Swisscontacti angazhoi një dizajner grafik zviceran dhe i investoi 3,000 euro në strategjinë e marketingut ku përfshiheshin pano, spote televizive, spote në radio dhe reklama në gazeta. Në vitin 2004, një nga ekspertët e Swisscontactit për verëra, z. Hans-Ulrich Kesslering, i siguroi Eko-s një vend në një konkurrencë verërash në Londër ku vera Syrah si verë anonime fitoi medalen e artë.

Pa marrë parasysh suksesin e shënuar në Londër, Eko ende shitet vetëm në tregun kosovar, kryesisht përmes rrjetit të shitoreve të mëdha dhe në restorante. Kohëve të fundit kjo kompani ka arritur një marrëveshje me Qeverinë e Austrisë për të filluar eksportimin e fillimisht 1,600 pakove me shishe vere. Ata gjithashtu së fundmi kanë hapur edhe një degë për marketing në Tiranë. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, shumë të huaj kanë vizituar verarinë Eko dhe kanë filluar negociatat me ta. Me shpresë se disa prej këtyre marrëveshjeve do të jetësohen, familja Hoxha veç ka filluar me përpunimin e katër hektarëve për vreshta të reja me çka do ta rrisin prodhimtarinë e tyre.

Dikur menaxhmenti i Eko-s refuzohej nga konsumatorët potencialë të huaj por këto refuzime po shndërrohen në kujtime të zbehta. “Kur e hapëm fillimisht verarinë Eko, ne kishim shumë probleme me individë që injoronin apo refuzonin ftesat dhe produktet tona. Ndjekësia shumë keq. Pyesja veten se kur do të mund të kthejmë investimin që e kemi bërë në vreshta dhe prodhimtari të verës” kujton kohërat e kaluara Bekimi. “Por më kujtohet një amerikan që na vizitoi në verari me një rast dhe na tha ‘duhet të prisni pesë vite, e pastaj do të jeni të sukseseshëm’ e më në fund koha jonë erdhi.”

Pasion për verë apo mjet për mbijetesë

Sektori i verës në Kosovë mbikëqyret nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), e themeluar në vitin 2001. Krahas 10 prodhuesve të verës të licencuar dhe rrjedhimisht të monitoruar nga MBPZHR në vitin 2006, gjashtë nga të cilët gjenden në Rahovec, nuk ekziston ndonjë listë e ditur e kultivuesve apo prodhuesve të tjerë të verës në Kosovë.⁵¹ Megjithatë, rreth 200 prodhues të peregjistruar të verës shesin produktet e tyre në mënyrë joformale, sipas Dr. Bashkim Korenica, profesor në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës.⁵² Regjistri i bizneseve të peregjistruara familjare mund të gjendet në restorante ku mysafirët kërkojnë “*venë të shtëpisë.*” Kjo verë, që zakonisht është mes verërave më të lira që shiten në restorante, zakonisht shitet në bure apo në kontejnerë tjerë të kapaciteteve më të mëdha. Pasi që shitet në mënyrë joformale dhe nuk i nënshtrohet tatimeve, kjo verë nuk paraqitet në ndonjë regjistrë zyrtar sa i përket konsumimit të verës në Kosovë. Zyrtarisht regjistrohen vetëm verërat e eksportuara dhe ato në shishe.

⁵¹ Intervistë e IKS me Nesim Morinën. Gjashtë prodhuesit e licencuar të verës në Rahovec janë Stone Castle, EKO, SHPK Rahoveci, Haxhijaha, Biopak, dhe Rahvera. Katër veraritë tjera janë Ereniku 1 dhe Ereniku 2 në Gjakovë, Kosovavera në Prizren, dhe Agrokosova Holding në Suharekë. Regjistrimi i prodhuesve të verës filloi në vitin 2006.

⁵² Intervistë e IKS me Bashkim Korenicën, 14 mars 2008.

Me dhjetëra vreshta të peregjistruara familjare janë të shpërndara anekënd komunës së Rahovecit. “Rahoveci është zemra e vreshtave dhe prodhimtarisë së verës” komentoi Sedat Kuqi, ish-drejtor i NBI Suhareka në komunën e Prizrenit. Shumica e familjeve në regjionin e Rahovecit kultivojnë vreshta dhe prodhojnë verë. “Është më shumë se thjeshtë punë, është pasion i tyre,” shtoi ai.

Familja e Zeki Musës⁵³ është pronare e një verarie të tillë të peregjistruar në Rahovec. Bashkëshortja e tij, Arta, është rrobaqepëse që fiton mjaft pak. Paga e Zekiut si punëtor komunal, që arrin rreth €150 në muaj, është e pamjaftueshme për të mbajtur familjen e tij gjashtë anëtarëshe. Ai filloi me përpunim të verës para katër vitesh për të mbijetuar nga një muaj në tjetrin. Ai nuk ka vreshtë të vetën, kështu që blen rreth 30,000 kilogramë rrush nga fermerët për çdo vit, me çmim prej €0.30 për kilogram. Më pas, ai prodhon rreth dhjetë deri në pesëmbëdhjetë mijë litra verë Vranac dhe e shet në shishe të plastikës me çmim prej €1 për litër. Ai prodhon edhe raki, edhe pse në sasi më të vogla. Mesatarisht, dy kilogram rrush Vranac japin një litër verë, ndërsa që shiset e plastikës i paguan nga €0.11 për copë. “Pra,” thotë ai me buzëqeshje, “llogariti vetë.” Nëse familja e tij do të shiste të gjitha 15,000 litrat, pa kalkular asnjë shpenzim tjetër përveç shisheve dhe rrushit, profiti i tij do të ishte rreth €4,350 në vit.

Zekiu zakonisht e shet verën e tij në mars. Duke qenë se përpunimi kryhet në vjeshtë, kjo shitje është mjaft e shpejtë. Shumica e konsumatorëve e vizitojnë atë në shtëpi dhe e blejnë verën atje. Ai nuk e ka regjistruar ende biznesin pasi që nuk ka shumë fitim dhe ende duhet të blejë shumë pajisje, siç na tha ai. Ai supozonte se nisja e biznesit të tij të vogël do të kërkonte investime prej rreth €20,000, pa përfshirë vreshtat. Megjithatë, biznesi i përpunimit të verës kërkon shumë punë, tha ai, kërkon ndihmë nga e tërë familja. Ai tha se nuk do ta bënte atë punë po të mos ishte e domosdoshme për mbijetesën e familjes së tij.

Zekiu dhe familja e tij nuk janë të vetëm; shumë familje nga rajoni kryejnë veprimtari të ngjashme. Në vjeshtë popullatën e Rahovecit mund ta gjeni duke shitur rrushin e vet të bardhë e të zi afër rrugës. Qeveria e Kosovës, sipas Shefit të Institutit të Verërave dhe Vreshtave, Nesim Morina, dëshiron ta promovojë këtë sektor jo vetëm për shkak të potencialit që Kosova ka për verari dhe vreshtari por edhe për shkak të ndikimit të këtij sektori tek familjet. “Prodhimi i rrushit dhe verës në veçanti gjenerojnë të dhëna për shumë familje,” tha ai.⁵⁴

⁵³ Shënim: në kaptinë nuk janë zbuluar emrat e vërtetë.

⁵⁴ Intervistë e IKS më 28 mars 2008.

Gjasat reale për rritje

Tabela 2. Shtetet eksportuese të verës në Kosovë në vitin 2007

Shteti	Përqindja e verës së importuar në Kosovë
Mali i Zi	62%
Italia	11%
Maqedonia	10%
Slovenia	5%
Serbia	4%
Spanja	3%
Franca	1%
Bullgaria	1%
Kroacia	1%
Zvicra	1%
Australia	1%
Meksika	<1%
Austria	<1%
Holanda	<1%
Portugalia	<1%
Gjermania	<1%
Kili	<1%
Greqia	<1%
Irlanda	<1%
Britania e madhe	<1%
Argjentina	<1%

Nga 4,928 hektarë me vreshta në Kosovë, 82 përqind përdoren për rrush të verës.⁵⁵ Me rendiment mesatar prej 7.5 ton për hektar,⁵⁶ me kapacitetet momentale mund të prodhohen deri në 30,285 ton rrush për verë. Kjo do të sillte prodhim prej afërsisht 18 milionë litra verë. Prodhimi aktual supozohet të jetë 25,033 ton (përafërsisht 15 milionë litra).⁵⁷ Veraria Stone Castle e vetme ka kapacitet për depozitim të një sasive prej 50 milionë litrash.⁵⁸

Përveç verërave të prodhuara lokalisht, janë rreth 20 shtete që eksportojnë verë në Kosovë. Në vitin 2007 janë importuar vetëm rreth 500,000 litra.⁵⁹ Siç paraqitet në tabelën 2, shtetet që eksportojnë verë më së shumti në Kosovë janë: Mali i Zi (me 62% të importit), Italia (11%), Maqedonia (10%), Sllovenia (5%), Serbia (4%), dhe Spanja (3%). Kosova gjithashtu ka importuar verë nga Spanja, Franca, Bullgaria, Kroacia, Zvicra, Australia, Meksiko, Austria, Holanda, Portugalia, Gjermania, Kili, Greqia, Irlanda, Britania e Madhe dhe Argjentina. Nga aspekti monetar, Kosova importon më së shumti nga Mali i Zi, që përbën përafërsisht 45% të vlerës totale të importit. Italia dhe Maqedonia mbulojnë rreth 30 përqind të importeve ndërsa

⁵⁵ Master Plani i Kosovës për Bujqësi (MPKB), projekt i financuar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), 2006.

⁵⁶ Master Plani i Kosovës për Bujqësi (MPKB), projekt i financuar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), 2006; 6.3t privat dhe 8.7t industrial.

⁵⁷ Master Plani i Kosovës për Bujqësi (MPKB), projekt i financuar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), 2006; 0.6 litra nga një kilogram rrush.

⁵⁸ Intervistë e IKS me Fejzullah Berishën dhe Rrahman Kabashin, 1 Shkurt 2008, Rahovec.

⁵⁹ Korrespondencë me email e IKS me Nesim Morinën, *Gjendja e Vreshtarisë në vitin 2009*, korrik 2009.

Sllovenia rreth gjashtë përqind. Vlera proporcionale në euro korrespondon me vlerën e verës së shpërndarë.⁶⁰

Sasia e gjithmbarshme e importuar e verës në Kosovë ka pësuar shumë pak lëkundje në disa vitet e fundit, duke shënuar rënie të gjithmbarshme prej tre përqind mes vitit 2005 dhe 2007. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se çmimi i verës së importuar është ngritur (shih Tabelën 3. Trendet e importimit të verës në Kosovë).⁶¹ Çmimi mesatar për litër i verës së importuar është ngritur për 55 përqind që nga viti 2005. Si rezultat i kësaj, vlera totale e eurove të shpenzuara në verërat e importuara është ngritur për 50 përqind. Duket qartë që Kosova është duke importuar verëra më të shtrenjta.

Tabela 3. Trendet e importimit të verës në Kosovë, 2005-2007

Viti	Importe (në litra)	% ndryshim	Çmimi mesatar i importit për litër	% ndryshim	Importe (në Euro)	% ndryshim
2005	927,952	100%	€ 2.06	100%	€ 1,913,161	100%
2006	1,014,144	109%	€ 2.79	135%	€ 2,832,188	148%
2007	897,131	97%	€ 3.20	155%	€ 2,871,325	150%
Mesatare	946,409		€ 2.68		€ 2,538,891	

Pra, ku gjendet tregu; kush po e pi këtë verë?

Master Plani i MBPZHR supozon se konsumi i verës për kokë banori për vit në Kosovë është rreth 6.5 litra,⁶² apo 13 milionë litra verë.⁶³ Megjithatë, ekspertët sikur Nesim Morina kanë parashikuar se kosovarët pinë vetëm rreth 2.2 litra për person në vit.⁶⁴

Gjatë viteve 2005-2007 mesatarja e eksporteve vjetore ishte 4.5 milionë ndërsa importet arritën 0.95 milion, nga të cilat 130,000 litra ishin verë lokale nga prodhues të verës të regjistruar dhe taksapagues. Nga 15 milionë litrat e prodhuara në vend, Master Plani i MBPZHR supozon që gjysma, apo 7.5 milionë, prodhohet në shtëpi në mënyrë joformale. Madje edhe nëse tërë sasia e verës së prodhuar në shtëpi shitet dhe konsumohet në tregun e zi dhe importet arrijnë 0.95 milionë, konsumi total i verës në vend nuk do të kalonte 8.5 milionë litra apo 4.25 litra për kokë banori.⁶⁵ Rrjedhimisht Kosova ka normën mes më të ulëtave të konsumit të verës në rajon. Vetëm Shqipëria me 3.35 dhe Bosnjë e Hercegovina me 1.78 litra për kokë banori renditen më ulët.⁶⁶ Për krahasim, konsumi mesatar i verës në BE është më i madh se 33 litra për kokë

⁶⁰ Korrespondencë e IKS me e-mail me Nesim Morinën, *Gjendja e Vreshtarisë në vitin 2009*, korrik 2009.

⁶¹ Të dhënat e importit-eksportit të doganave të UNMIK-ut për vitet 2005-2007.

⁶² Master Plani i Kosovës për Bujqësi (MPKB), projekt i financiar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), 2006, faqe 31.

⁶³ Kosova supozohet se ka popullatë prej rreth dy milionë banorë.

⁶⁴ Korrespondencë e IKS me e-mail me Nesim Morinën, korrik 2009, faqe 8.

⁶⁵ Konsumi i gjithmbarshëm i verës në Kosovë është paraparë të jetë rreth dy milionë verë në vit (intervistë e IKS me Ylber Bajraktari, Zyrtar i Verërave, MBPZHR, Instituti i Verëtarisë dhe Vreshtarisë, Rahovec 28 janar 2008).

⁶⁶ Në vitin 2005, shtetet tjera të rajonit kanë konsumuar për kokë banori sasinë e litrave si në vijim: Sllovenia – 43.77, Kroacia – 42.27, Greqia – 22.92, Bullgaria 18.96, dhe Maqedonia – 10.24. të dhënat e marra nga Data and Analysis (TDA).

banori.⁶⁷ Konsumi i verërave lokale gjithashtu ka shënuar rënie; më se 168,000 litra verë kosovare është konsumuar në vitin 2005 krahasuar me vetëm 93,000 litra në vitin 2007.⁶⁸

Me vetëm dy milionë banorë dhe me përafërsisht 45 përqind të popullatës që jetojnë në varfëri,⁶⁹ vera vazhdon të mbetet një luks të cilin vetëm disa mund t'ia lejojnë vetes. Një pronar i një restoranti lokal nga Rahoveci komentoi, “Stone Castle është një verë tejet cilësore, por është e shtrenjtë për popullatën e Kosovës nëse e krahasojmë çmimin me atë që shumica fiton.”⁷⁰ Për këtë arsye vetëm gjashtë verëritë e regjistruara të Rahovecit prodhojnë katër herë më shumë se sasia e verës që Kosova e konsumon brenda një viti. Me një treg aq të vogël lokal të verës, e ardhmja e industrisë së verëtarisë së Kosovës varet kryesisht nga eksportet.

Drejt Evropës e më pas drejt botës

Ndonëse gjatë tre viteve të fundit ka pasur një balancim pozitiv të tregtisë në litra vere, tregtia në vlera të Euros ka pësuar deficit (shih Tabelën 4. Eksportet e Kosovës prej 2005 deri 2007). Eksportet mesatare vjetore prej 4.5 milionë litrave kalonin importet që sillleshin rreth 0.95 milionë litra. Megjithatë, mesatarisht 2.5 milionë Euro janë paguar për importet dhe vetëm 1.7 milionë Euro janë pranuar për eksportet. Dallimi në çmim është për shkak të faktit se Kosova kryesisht eksporton verëra të cilësisë së ulët në masë ndërsa importon verëra cilësore në shishe. Verërat e importuara, mesatarisht 2.68 Euro për litër, janë me çmim shtatë herë më të lartë se çmimet e produkteve kosovare të eksportuara, që kushtonin vetëm 0.38 Euro për litër.⁷¹

Tabela 4. Eksportet e Kosovës prej 2005 deri 2007⁷²

Viti	Eksportet (në litra)	% ndryshim	Çmimi mesatar i eksportit për litër	% ndryshim	Eksportet (në Euro)	% ndryshim
2005	3,999,418	100%	€ 0.39	100%	€ 1,569,553	100%
2006	4,075,753	102%	€ 0.41	105%	€ 1,684,870	107%
2007	5,590,254	140%	€ 0.33	83%	€ 1,831,179	117%

⁶⁷ KE Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, “Dokument pune: Vera: Ekonomia e Sektorit,” Shkurt 2006, faqe 12, mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/agriculture/markets/wine/studies/rep_econ2006_en.pdf, qasur më 5 qershor 2009.

⁶⁸ Korrespondencë e IKS me e-mail me Nesim Morinën, *Gjendja e Vreshtarisë në vitin 2009*, Korrik 2009.

⁶⁹ Republika e Kosovës, Ministria e Administratës Publike, Enti Statistikor i Kosovës; shih www.ks-gov.net/esk/eng

⁷⁰ Intervistë e IKS më 14 Shkurt 2008, Rahovec.

⁷¹ Në vitin 2007, vera e importuar kushtonte mesatarisht 2,150 Euro për tonelatë gjersa vera e eksportuar shitej për vetëm 430 Euro për tonelatë (Shërbimi Doganor, 2007, i cituar nga Nesim Morina në korrespondencë me IKS, Korrik 2009, f. 7).

⁷² Doganat e UNMIK-ut, 2005-2007, të dhëna të papërpunuara të importit dhe eksportit. Autoriteti i ri doganor i Kosovës nuk ofroi të dhënat më të fundit të importit dhe eksportit kur u kërkuan nga IKS-i në Qershor 2009.

Importi i verërave me çmim më të lartë pjesërisht mund të jetë si shkak i pranisë së madhe ushtarake dhe civile ndërkombëtare në Kosovë. Qindra ndërkombëtarë me qëndrim në Kosovë kanë rroga të tilla që u mundësojnë të blejnë verëra të cilat janë të papërbalueshme për shumicën e popullatës vendore. Megjithatë, verërat ndërkombëtare mund të preferohen edhe nga klasa e vogël elite e Kosovës. “Në Kosovë, shumica e njerëzve preferojnë dhe kanë dëshirë çdo gjë të huaj, duke menduar se janë më të mira sesa produktet tona,” thotë Halim Haxhijaha, pronar i verarisë Haxhijaha. “Neve na duhet më shumë nacionalizëm ekonomik, do të thotë, konsumim më të madh të produkteve vendore.”⁷⁴ Veraria Haxhijaha ishte në bisedime me Kroacinë dhe Zvicrën për të filluar eksportimin, si dhe pronarët Italianë të AgroKosova Holding kanë bërë plane për të eksportuar në Angli, Rusi dhe ShBA.⁷⁵

Tabela 5. Eksportet e Kosovës sipas shteteve në vitin 2007⁷³

Shteti	Përqindja e eksporteve të Kosovës
Serbi	57%
Gjermani	35%
Austri	4%
Kroaci	2%
Maqedoni	1%
Xhamajkë	1%
Irlandë	< 1%
Shqipëri	< 1%

Sidoqoftë, sikurse ilustron Tabela 3, Kosova ka shënuar një rritje drastike (140 për qind në litra dhe 117 për qind në Euro) të eksporteve të saj ndërmjet 2005 dhe 2007. Aktualisht, eksportet e Kosovës janë të përqendruara në rajonin e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë – CEFTA.⁷⁶ Në vitin 2007, Kosova ka eksportuar 5,400 tonelata verë, kryesisht në Serbi (57% të eksporteve) dhe Gjermani (35%). Sikurse tregon Tabela 5, Kosova ka eksportuar verë edhe në Austri, Kroaci, Maqedoni, Xhamajkë, Irlandë dhe Shqipëri.

Gjermania ka prirje të blejë verëra me çmime më të larta, me një shumë fikse prej 0.48 Euro për litër, krahasuar me 0.22 deri 0.29 Euro për litër të paguar nga Serbia.

Sipas Bajram Hajrullahut nga veraria Rahvera, është në dukje një e ardhme pozitive për eksportin e verërave në Shqipëri.⁷⁷ “Ata janë konsumatorë të mirë të verërave, si dhe kanë shumë pak verari,” thotë ai. Në vitin 2003, pas 15 ditë hulumtimi në Shqipëri, Bajrami ka identifikuar vetëm një verari; rreth 80 për qind të verërave të shërbyera në kafetë dhe restorantet e Shqipërisë janë nga jashtë, thotë ai. Në të vërtetë, në vitin 2005, Shqipëria ka prodhuar vetëm 100 hektolitra verë.⁷⁸ Veç kësaj, Shqipëria mund të ketë një industri të rritur turistike me bregdetin e saj të gjatë malor që prek ujërat e thella e të kaltra të dy deteve. Hulumtimi i tregut mund të jetë i dobishëm për të identifikuar mënyra për një zgjerim fitimprurës në këtë shtet fqinj.

⁷³ “Eksporti i verës 2007” (Wine Exports 2007), Shërbimi Doganor i Kosovës, cituar nga Nesim Morina në korrespondencë me IKS-in.

⁷⁴ Intervistë e IKS-it me Halim Haxhijaha, bashkëpronar i verërisë Haxhijaha, 12 mars 2008.

⁷⁵ *Po aty*.

⁷⁶ CEFTA përfshin Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë, Moldavinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën (botim i Odës Ekonomike të Kosovës mbi CEFTA-në, 2007). Palët e mëhershme, që përfshinin Bullgarinë, Republikën Çeke, Hungarinë, Poloninë, Rumaninë, Sllovinë dhe Slloveninë, ndërprenë pjesëmarrjen e tyre kur hynë në BE.

⁷⁷ Intervistë e IKS-it, 11 shkurt 2008.

⁷⁸ Të dhëna dhe analiza tregtare (TDA), në: <http://www.wineinstitute.org/files/WorldWineProductionbyCountry.pdf>, të qasura më 27 maj 2009.

Por shumë prodhues kishin shpresa të mëdha sa i përket zgjerimit në tregjet e BE-së apo madje më gjerë. “Ne e kemi cilësinë e verës të cilën e do bota sot,” komenton Shani Hoxha, Menaxher i shitjeve në Stone Castle. Ai beson se cilësia e lartë e verërave të tyre do të kishte sukses në Evropë. “Ne duhet të kthejmë tregun e humbur” pajtohet Haxhijaha “duke përmirësuar cilësinë, marketingun, si dhe me paketim të mirë.” Ai tha se kjo do të jetë sfiduese për shkak të tepricës aktuale të verërave në shtetet perëndimore. Është vështirë të gjesh pozitë në tregun ndërkombëtar, tha ai.

Hyrja në tregjet e BE-së duhet të jetë qëllimi përfundimtar i Kosovës. Në vitin 2004, BE-ja ka importuar 11.6 milionë hektolitra nga furnizuesit kryesorë, duke përfshirë Australinë, Evropën Lindore dhe shtetet Mesdhetare.⁷⁹ Vetëm ShBA-ja ka raportuar se më shumë se 60 për qind e eksporteve të saj ka shkuar në BE në vitin 2007.⁸⁰

Deri më tani, Kosova ka eksportuar më shumë se shtatë milionë litra verë për në Gjermani, Serbi, Shqipëri dhe Maqedoni, prej vitit 2005 deri 2007, duke kapur shumën prej më shumë se 5 milionë Euro në shitje.⁸¹ Gjatë dy viteve të fundit, më shumë se 60 për qind të eksporteve të Kosovës kishin destinacion vendet e BE-së (kryesisht Gjermaninë),⁸² duke treguar se ka kërkesa edhe për prodhuesit e Kosovës që të lejohen në tregjet e BE-së.

NË RRUGË PËR BRUKSEL

Pas më shumë se një viti nga shpallja e pavarësisë, Kosova ende nuk është pranuar nga të gjitha shtetet e BE-së. Ndonëse shtet në zhvillim, Kosova duhet t’i respektojë të gjitha rregulloret e BE-së, nëse dëshiron të hyjë në tregjet e BE-së. Autoritetet e Kosovës janë përgjegjëse për rregullimin e brendshëm të sektorit të verërave në mënyrë që verërat të mund të lëvizin lirshëm jashtë vendit, përfshirë edhe përbrenda BE-së. Po aq i rëndësishëm për rregullim të brendshëm është ndërlidhja e jashtme. Që tregtia të ketë sukses, autoritetet e Kosovës duhet të koordinohen me organet relevante të BE-së.

Pika e parë që pengon Kosovën të hyjë në tregjet e BE-së është se Kosova ende nuk është pranuar nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Prandaj, Kosova nuk mund të krijojë marrëdhënie me BE-në; ajo duhet të mbështetet në marrëveshje bilaterale me shtetet anëtare individuale. Në këtë kuptim, fati i eksporteve të Kosovës qëndron në duart e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe po aq sa në ato të Ministrisë së Bujqësisë.

⁷⁹ Drejtorja e KE-së për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, “Dokument Pune: Verërat: Ekonomia e Sektorit,” shkurt 2006, f. 59

⁸⁰ Byroja e regjistrimit, DOC në Shari Kosco, Shërbimi i huaj bujqësor, “ShBA-ja dhe Gjendja botërore e verërave,” OGA/ISA/SCFB, maj 2008. Në dispozicion në: <http://www.fas.usda.gov/http/2008%20Wine%20Charts.pdf>, e qasur më 27 maj 2009.

⁸¹ Doganat e UNMIK-ut, 2005-2007, të dhëna të papërpunuara. Në vitin 2007, Kosova, po ashtu, ka eksportuar 258 tonelata trush të freskët për në Mal të Zi, Gjermani dhe Shqipëri (Shërbimet doganore, 2007, cituar nga Nesim Morina në korrespondencën përmes postës elektronike me IKS-in, korrik 2009).

⁸² Ibid.

Problemi i dytë qëndron brenda administratës së Kosovës; prodhimtaria e verës është praktikisht e parregulluar. Legjislacioni primar, Ligji për Verërat, i miratuar në fund të vitit 2005,⁸³ është i mjaftueshëm dhe në pajtim me rregulloret e BE-së. Ajo që mungon është zbatimi i tij dhe aktet përkatëse nënligjore. Departamenti i Prodhimtarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve pranë MBPZHR-së, themeluar në vitin 2001, është përgjegjës për nxitjen e procesit të hartimit të legjislacionit të ri që ka të bëjë me vreshtat dhe verarinë. Megjithatë, nga 12 Udhëzimet administrative që duhet nxjerrë në pajtim me Ligjin mbi Verërat, janë aprovuar vetëm tre prej tyre deri në fund të vitit 2008.⁸⁴ Kjo ka penguar zbatimin e plotë të Ligjit.⁸⁵

Si rrjedhojë, ekziston një hutim i madh që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe llogaridhënien ndërmjet institucioneve. Ekzistojnë vakume ligjore në lidhje me kompetencat që kanë komunat dhe ato që kanë institucionet e tjera qeveritare. Për shembull, inspektorët komunalë fitosanitarë vazhdojnë të përdorin ligjin e vjetër të vitit 1983 në mungesë të një ligji të ri mbi inspektimin bujqësor.⁸⁶ Ligjet e reja mbi plehrat artificiale, pesticidet, materialet mbjellëse, farërat dhe verërat përfshijnë detyra të lidhura me inspektimin, po jo në lidhje me bujqësinë.⁸⁷ Veç kësaj, ato nuk sqarojnë rolin e strukturave të qeverisë dhe të komunave. Në ligjin e vjetër të 1983 mbi inspektimin bujqësor, marrëdhëniet ishin më të qarta; inspektorët qeveritarë fitosanitarë merreshin me çështjet kryesore përdërisa inspektorët komunalë vetëm me çështjet lokale dhe pastaj i raportonin qeverisë. Sot, përgjegjësitë e paqarta kontribuojnë në konfuzion, si për shembull inspektorët komunalë dhe shtetërorë vizitojnë të njëjtën kompani brenda pak ditëve. “Kjo krijon konfuzion të udhëheqësit e kompanive,” tha Besa Krasniqi, ushtruese detyre Kryesuese e Inspektoratit Fitosanitar. Ndonëse ajo bashkëpunonte mirë me inspektorët komunalë ajo mendonte se marrëdhënia duhet të rregullohet me ligj. Si rrjedhojë, në vitin 2008 ata aplikonin Ligjin mbi Inspektimin Bujqësor të vitit 1983, i cili ishte shumë i hollësishëm dhe profesional, sipas Krasniqit.

Konfuzion i mëtejshëm ekziston në lidhje me kontrollin e cilësisë së produkteve të verës.

Afër stacionit të autobusëve në qytetin e Prizrenit në një ndërtesë të vjetër njëkatëshe gjendet zyra rajonale e MBPZHR. Afër hyrjes është Zyra e Inspektorëve Fitosanitarë, një shërbim nën Departamentin e Mbrojtjes dhe Prodhimtarisë së Bimëve me nëntë inspektorë në tërë Kosovën.⁸⁸

⁸³ Ligji nr. 02/L-8 mbi Verërat dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2005/47 mbi shpalljen e Ligjit për Verërat të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji është miratuar pas konsultimeve me ekspertë të verërave, përfshirë ekspertë nga Rahoveci (intervistë e IKS-it me Avdullah Kryeziun, ish drejtor i Divizionit të Bujqësisë në Komunën e Rahovecit, 15 janar 2008).

⁸⁴ Intervistë e IKS-it me Nesim Morinën. Udhëzimet administrative të aprovuara janë mbi: caktimin e institutit të autorizuar për kryerjen e analizave, hulumtimeve dhe vlerësimeve të verërave në Kosovë (nr. 2003/02); për regjistrimin dhe licencimin e kultivuesve të rrushit, prodhuesve dhe përpunuesve të verës (MA-Nr. 06/2006); për përcaktimin e kriterëve për marrjen e mostrave dhe vlerësimin e verës (MA-Nr. 11/2006); mbi regjistrat e brendshëm dhe të jashtëm të kompanive prodhuese të rrushit, verës dhe produkteve tjera nga rrushi dhe verërat (Nr. 24/2008). Udhëzimi administrativ mbi rolin dhe mandatin e Institutit Kosovar të Bujqësisë (Nr. 2003/3) është po ashtu i rëndësishëm për rregullimin e industrisë së verërave. Vendimi i MBPZHR 04/2007 ishte mbi themelimin e Institutit të Verës dhe Vreshtave në Rahovec, bazuar në nenin 4 të Ligjit për verërat.

⁸⁵ Intervistë e IKS-it me Nesim Morinën, 28 mars 2008.

⁸⁶ Intervistë e IKS-it me Besa Krasniqin, ushtruese detyre Kryesues i Inspektoratit Fitosanitar, MBPZHR, Komuna e Prizrenit, 2 prill 2008.

⁸⁷ Shih ligjin 2003/10 mbi Plehrat artificiale, neni 6; Ligji 2003/20 mbi Pesticidet, neni 17; Ligji 2004/13 mbi Materialet Mbajllëse, neni 20; Ligji 2003/4 mbi Farërat; dhe Ligji mbi Verërat, 20L-8, neni 45-6.

⁸⁸ Intervistë e IKS-it me Besa Krasniqin, ushtrues detyre Kryeinspektor Fitosanitar, MBPZHR, Komuna e Prizrenit, 2 prill 2008.

Vetëm dy inspektorë janë përgjegjës për tërë rajonin e Prizrenit, duke mbuluar prodhuesit në pesë komuna: Prizren, Rahovec, Suharekë, Malishevë dhe Dragash. Inspektorët janë përgjegjës për kontrollimin e të gjithë prodhuesve bujqësorë të materialeve ushqimore, bimëve dhe pijeve joalkoolike dhe alkoolike, përfshirë cilësinë e farërave dhe plehrave artificiale.⁸⁹

Inspektorët fitosanitarë janë aktorë të rëndësishëm në sektorin e verërave dhe vreshtave. Ata kontrollojnë cilësinë e verës së prodhuar nga veraritë me licenca nga MBPZhR dhe marrin mostra të verërave çdo vit. Po ashtu, është me rëndësi se ata lëshojnë certifikata fitosanitare për eksportimin e mallrave bujqësore, përfshirë verërat. Ata bashkëpunojnë me Institutin Bujqësor të Pejës, ku edhe i dërgojnë mostrat. Bazuar në analizat kimike, ata lëshojnë certifikata fitosanitare.

Inspektorët pastaj janë përgjegjës për të shpjeguar problemet e identifikuara më vonë me produktet të cilat i kishin aprovuar. Deri më sot, nuk janë bërë fare gabime. Megjithatë, një herë kanë pasur probleme me verën e eksportuar në Gjermani. Në një nga shtatë cisternat e kontrolluara, janë gjetur gjurmë vaji, pasi kishte mbërritur në Gjermani. Ministria krijoi një komision prej nëntë anëtarëve për të identifikuar arsyet. Komisioni, bazuar në testimet e mëhershme, vërtetoi se vaji ishte gabim i kompanisë përgjegjëse për transport.⁹⁰

Sipas Ligjit për verërat, inspektorët janë të autorizuar, aty ku konsiderohet si e nevojshme, që të urdhërojnë shkatërrimin e stoqeve të verërave, bllokimin e shitjeve të produkteve, të konfiskojnë produktet e dëmtuara, të urdhërojnë riklasifikimin e verërave në kategori më të ulëta, të ndërpresin aktivitetin në objekte të verarive si dhe të ndalojnë importin apo eksportin e mallrave që dështojnë në përmbushjen e kriterëve të vendosura.⁹¹ Në pajtim me Ligjin për verërat, “inspektori adekuat” duhet të parandalojë vendosjen e verës me cilësi të ulët në treg. Megjithatë, aktualisht inspektori i verërave është njëri nga inspektorët fitosanitarë të cilët merren edhe me produkte tjera ushqimore. Kosova ka nevojë për inspektorë të përqendruar në verari dhe sektorin e verës sepse, sipas Morinës, inspektorët e përgjithshëm nuk mund t’i mbulojnë të gjithë sektorët.⁹²

Një vakum tjetër në proces është kontrolli i verës dhe rakisë shtëpiake që shitet joformalisht nga operator të paregjistruar bujqësorë. Inspektorët kanë vështirësi t’i gjejnë ata. Krasniqi i ka propozuar udhëheqësisë së saj që të merret një vendim që do të lejonte inspektorët që të kontrollojnë verën e shërbyer në hotele dhe restorante që shpeshherë vjen nga prodhues privatë familjarë. Në këtë mënyrë, inspektorët do të mund të identifikonin se ku gjenden prodhuesit joligjorë.

Deri më 2008, Zyra është përballur me sfida të tjera. Ata nuk kanë pasur buxhet të tyre, dhe veturat e tyre të vjetra rrallëherë mund t’i transportonin ata në lokacionet për inspektim. Zyra

⁸⁹ Intervistë e IKS-it me Besa Krasniqin, 2 prill 2008.

⁹⁰ Intervistë e IKS-it me Besa Krasniqin, 2 prill 2008.

⁹¹ Ligji për verërat, 20L-8, neni 46.2.

⁹² Intervistë e IKS-it me Nesim Morinën, 28 mars 2008.

ishite e pajisur me kompjuter, por nuk kishte lidhje interneti dhe telefoni. Sipas Krasniqit, këto çështje e vështirësonin tej mase punën e tyre, posaçërisht meqë kohën më të madhe të punës duhej ta kalonin në terren.

Kur ata ishin në gjendje të kryenin përgjegjësitë e tyre, puna ishte shpeshherë e tensionuar dhe disa herë e rrezikshme, tha ajo. “Askush nuk mund të imagjinojë se si është të punosh si inspektor. Ju duhet t’i luani tri role: psikologun, politikanin dhe profesionistin,” theksoi ajo. “Fatmirësisht, unë ende nuk jam e martuar sepse është [punë] e vështirë. Disa herë policia ju thërret në mbrëmje... apo gjatë fundjavave kompanitë dëshirojnë të eksportojnë mallra [dhe] ju duhet të ofroni këtë shërbim. Nuk ka kompensim për punë gjatë fundjavave.” Ndonëse janë ndërmarrë masa sigurie dhe situata është përmirësuar, ajo thotë se puna e tyre ende është e rrezikshme. “Situata sot krahasuar me atë të vitit 1999 është sikur dita me natë. [N]ë atë kohë, njerëzit kishin armë dhe ishte shumë e rrezikshme të sekuestroje mallra ... apo madje të kërkohej dokumentet,” kujtohet Krasniqi.

Pas kryerjes së analizave analitike, MBPZhR-ja duhet çdo vit të krijojë një Komision me së paku pesë anëtarë që të përcaktojë cilësinë e verës, apo siç njihet vlerësimi organoleptik (degustues). Përbërja e komisionit ndryshon nga viti në vit. Ndërsa anëtarët e komisionit janë agronomë të kualifikuar me përvojë në sektorin e verërave apo të trajnuar në enologji,⁹³ ata nuk janë enologë të certifikuar, që është kërkesë e komisionit të BE-së. Instituti dërgon një shishe verë te çdo anëtar i komisionit dhe ata vlerësojnë verën në mënyrë të pavarur. Pastaj, MBPZhR-ja duhet të lëshojë një certifikatë lidhur me cilësinë e verës: verërat e vlerësuara me “një” nuk kanë kurrfarë cilësie dhe distilohen menjëherë. Të tjerat vlerësohen si verëra cilësore, verëra tryeze apo nëse vlerësimi është më i lartë se 17 pikë, verë kulminante. Deri në vitin 2006, Instituti i Pejës ishte përgjegjës për mbajtjen e një shishe shtesë të verës për një vit për super-analiza kimike, nëse ato kërkoreshin nga ndonjë institucion apo kompani e cila nuk pajtohej me rezultatin. Që atëherë, këto kompetenca janë bartur në Institutin e Rahovecit, por Instituti i Pejës ende ofron mbështetje, meqë pa laboratorë ata janë vetëm gjysmë-funksionalë.⁹⁴

MBPZhR-ja në vitin 2003 ka shpallur një Udhëzim Administrativ që autorizonte Institutin e Pejës që të kryen analiza, hulumtime dhe vlerësime të verërave në Kosovë.⁹⁵ Në vitin 2007, është themeluar Instituti për Verëra dhe Vreshta në Rahovec. Që atëherë, të gjitha analizat që kanë të bëjnë me vreshtat dhe verërat bien në përgjegjësi të Institutit të Vreshtave dhe Verërave në Rahovec. Por, aktualisht Instituti i vetëm me laborator për analiza të verërave është Instituti i Pejës, dhe në realitet ata vazhdojnë të kryejnë analizat analitike-kimike. Instituti në Rahovec kryen vetëm analizat *organoleptike (degustimin)* dhe grumbullimin e mostrave të verërave nga prodhuesit e verërave në Kosovë prej vitit 2007.⁹⁶

⁹³ Enologjia është shkencë e verërave dhe prodhimit të verërave.

⁹⁴ Intervistë e IKS-it me Shaban Ajdinin, Zyrtar për Vreshta dhe Verëri, Instituti Bujqësor i Pejës, Komuna e Pejës, 29 shkurt 2008.

⁹⁵ Udhëzim Administrativ nr. 2003/02 mbi “Caktimin e Institutit të Autorizuar për kryerjen e analizave, hulumtimeve dhe vlerësimeve të verërave në Kosovë.”

⁹⁶ Intervistë e IKS-it me Shaban Ajdinin, 29 shkurt 2008 dhe Nesim Morinën, 5 qershor 2009.

Gjendja në terren

Duhet të ekzistojë një pajtueshmëri e madhe me rregulloret e BE-së, në mënyrë që prodhuesit kosovarë të mund të eksportojnë te shtetet anëtare të BE-së. Aktualisht, ekzistojnë barriera në lidhje me tri fusha kryesore: etiketimi, procedurat e përpunimit dhe dokumentacioni. Së pari, etiketat e shisheve të verës duhet të përmbajnë informata në lidhje me shtetin e prejardhjes, rajonin gjeografik (nëse zbatohet), vëllimin nominal, fuqinë aktuale të alkoolit, emrin e importuesit dhe shtetin anëtar, cilësinë ose “notën” e verës, si dhe përbërësit alergjenikë.⁹⁷ Nëse përmirësohet funksionimi i mekanizmave të brendshëm të Kosovës, etiketimi i duhur është pengesë që mund të tejkalohet lehtë.

Më sfidues është kontrolli institucional i procedurave të përpunimit të verërave. Ndonëse procedurat janë të definuara në mënyrë të qartë në rregulloret e BE-së,⁹⁸ mënyra se si do të kontrollohet apo zbatohet “pajtueshmëria me praktikën enologjike të Komunitetit” mbetet e paqartë. Nëse nga rreth 200 prodhues të verërave në Kosovë, MBPZhR ka regjistruar vetëm 10 syresh, mund të imagjinohet se në çfarë mase kontrollohet prodhimtaria. Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 06/2006, “Të gjithë kultivuesit e rrushit, prodhuesit dhe përpunuesit e verërave në pajtim me nenin 5 të Ligjit për verërat duhet të regjistrohen dhe licencohen në regjistrin e [...] MBPZhR.” Po ashtu, ata duhet të aplikojnë për licencë nga Departamenti i mbrojtjes së bimëve dhe prodhimit.⁹⁹ Megjithatë, është e qartë se udhëzimi nuk është duke u zbatuar kur merren parasysh bizneset e sapopërmendura të paregjistruara familjare.

Çështja e fundit, posedimi i dokumentacionit të duhur, nuk lejon hapësirë për manipulim nëse prodhuesit janë seriozë për eksportet, që ata duket të jenë. Disa nga dokumentacionet e kërkuara administrative mund të sigurohen thjeshtë: licencat e përgjithshme për import nga shtetet anëtare, formularët V12 të vulosur doganat,¹⁰⁰ certifikata e Tatimit të Vlerës së Shtuar (TVSh) e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), certifikatat e import-eksportit të lëshuara nga doganat, deklaratat e faturave, kontratat e shitjes, autorizimet nga kompanitë eksportuese, si dhe Dokumentin Unik Doganor – DUD-in. Deri në 100 litra në kontejnerë të ndarë pesëlitëresh, BE-ja nuk kërkon asnjë certifikatë.¹⁰¹

Në mesin e dokumentacionit të kërkuar, janë tri dokumente problematike për prodhuesit kosovarë të verës: certifikata e verës dhe analiza e një laboratorit të pranuar ndërkombëtarisht; certifikata e prejardhjes EUR1 e lëshuar nga MTI apo Oda Ekonomike e Kosovës (OEK); si dhe certifikata sanitare L03.

⁹⁷ Rregullorja e Komisionit Evropian 883/2001 mbi kërkesat për etiketim të importit

⁹⁸ Rregullorja e Këshillit 1493/1999, neni 45, dhe Rregullorja e Komisionit 883/2001, neni 31.

⁹⁹ Udhëzimi Administrativ, Nr. 06/2006 “Për regjistrimin dhe licencimin e kultivuesve të rrushit, prodhuesve dhe përpunuesve të verërave,” nenet 2, 4.

¹⁰⁰ Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 883/2001, 24 prill 2001, publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian (L 128/1), nenet 25, 28, dhe 59.

¹⁰¹ Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 883/2001, 24 prill 2001, publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian (L 128/1), neni 22.

Çka jam duke pirë dhe prej nga është

Së pari, certifikata dhe analiza e verërave duhet të lëshohen në shtetin e prejardhjes së produktit nga një organ i duhur, përkatësisht një laborator ndërkombëtarisht i pranuar.¹⁰² Për këtë arsye, kërkohet formulari VII për çdo sasi të verës mbi njëqind litra. Pyetja është nëse Kosova formalisht ka themeluar “organe zyrtare” të tilla. MBPZhR është përgjegjëse për akreditimin e këtyre organeve dhe për të aplikuar në BE që ky organ të pranohet dhe të shtohet në listën e tyre zyrtare. Aktualisht, institucioni i vetëm që kryen analiza të verërave është Instituti Bujqësor në Pejë, kompetencat e të cilit kanë filluar të dyfishohen me Institutin e Verërave të posa hapur në Rahovec. Veç kësaj, asnjëri nga këto institute nuk janë të pranuar zyrtarisht si institute të verërave nga ana e BE-së, gjersa shtetet tjera në rajon kanë së paku një institut të tillë të pranuar. Kosova ka nevojë për një institut funksional, të pranuar nga BE-ja, që të ofrojë dokumente zyrtare në mënyrë që produktet e Kosovës të hyjnë në tregjet e BE-së në mënyrë ligjore.

Nevoja për të themeluar një institut nuk është e re për prodhuesit kosovarë të verërave dhe agronomët të cilët kanë kërkuar për shumë kohë themelimin e një instituti të verërave dhe vreshtave në Rahovec, ku janë me vendndodhje shumica e prodhuesve dhe kultivuesve kosovarë. Gjatë një simpoziumi mbi vreshtat në Rahovec në vitin 1997, prodhuesit e verës kanë identifikuar nevojën e themelimit të një instituti të specializuar në afërsi të tyre. Ata ishin të vetëdijshëm se themelimi i një instituti është thelbësor për të ardhmen e prodhimit të verërave në Rahovec.

Ideja e tyre fillestare mbeti e pazhvilluar deri në vitin 2005 kur MBPZhR filloi projektin e themelimit të një instituti me mbështetjen e GTZ-së (*Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit*). Në vitin 2007, Sekretari i Përhershëm i MBPZhR-së aprovoi Vendimin 04/2007 mbi Themelimin e Institutit të Verërave dhe Vreshtave në Rahovec bazuar në nenin 4 të Ligjit për Verërat. Kuvendi Komunal i Rahovecit siguroi ndërtesën dhe Qeveria e Kosovës dhuroi afro 50,000 Euro për renovimin e saj. GTZ ndihmoi me inventar dhe trajnime profesionale për gjashtë pjesëtarët e stafit të Institutit. Dera e përparme në ndërtesën dykatëshe ngjyrë roze bart simbolin e fuçisë së verës dhe rrushit, donacion nga Kuvendi Komunal i Rahovecit.

Instituti është hapur në nëntor të vitit 2007 me dy sektorë: Sektori i Vreshtave dhe Sektori i Verarisë, si dhe nënsektori për përpunim të të dhënave (kadastru). Instituti udhëhiqet sipas nenit 4 të Ligjit për verërat; përgjegjësitë e tij përfshijnë mbajtjen e regjistrit të vreshtave; mbajtjen e regjistrit të rrushit dhe kultivuesve të rrushit; përshkrimi i varieteteve të rekomanduara dhe të autorizuara të verërave dhe varietetet e rrënjëve të verës; monitorimi i pjekurisë së rrushit dhe përcaktimi i kohës së vjeljes; kufizimi i rendimenteve maksimale për një hektar të rrushit, pavarësisht nga varieteti dhe destinimi; si dhe vlerësimi dhe përcaktimi i verës dhe produkteve tjera. Megjithatë, detyrat e vetme që aktualisht kryhen rregullisht nga Instituti janë vlerësimi zyrtar organoleptik i verës së prodhuar në Kosovë (p.sh. ekzaminimi vizual, të ndjerit dhe të

¹⁰² Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 883/2001, 24 prill 2001, publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian (L 128/1), neni 20.

nuhaturit e produkteve të verës), trajnimi i stafit, si dhe përgatitja për themelimin e një regjistri gjithëpërfshirës të vreshtave në Kosovë, apo siç njihet, kadastrin.

Krijimi dhe menaxhimi i kadastrit të vreshtave është detyrë e rëndësishme për Institutin. Themelimi i kadastrit është hap kyç drejt mundësisë për lëshimin e dokumenteve të nevojshme për eksport për në BE. Vreshtat, varietetet, dhe rendimenti nuk mund të kontrollohen si duhet pa pasur njohuri se ku janë, në çfarë sasive dhe çka rritet në vreshtat e Kosovës. “Pa kadastrë nuk është e mundur të sigurohet prodhimi i verës së mirë sepse nuk e dihet se ku kemi çka,” komentoj Shaban Ajdini, Zyrtar për Vreshta dhe Verari në Institutin e Bujqësisë në Pejë.¹⁰³ “Nëse vjen një blerës serioz dhe provon një Chardonnay nga një kompani, ai do të kërkojë të dijë se nga cili rajon vjen dhe cili është numri i kadastrit në mënyrë që të mund të kërkojë atë verë të caktuar.” Aktualisht, vetëm pronarët e vreshtave kanë qasje në informatat mbi vreshtat, kontrollin e marrjes së mostrave, dhe varietetet e rrushit që rritet. Kontrolli më i mirë institucional i këtyre informatave është tejet i rëndësishëm për mbajtjen e standardeve të larta të prodhimit.

Fatkeqësisht, historia e prodhimit të verërave në Kosovë gjatë njëzet e ca viteve të fundit mbijeton vetëm në dorëshkrime dhe memoare të njërit prej punëtorëve më të vjetër të Institutit Bujqësor, Shaban Ajdinit. Zyra e tij gjendet në afërsi të Institutit të Pejës në një banesë dykatëshe, ngjyrë hiri, instituti i vetëm i akredituar bujqësor në Kosovë. I themeluar para gjysmë shekulli, ai mëton të përmirësojë standardet bujqësore në Kosovë. Vreshtat jashtë Institutit të Bujqësisë dikur përfshinin mbi 100 varietete të rrushit për hulumtim shkencor. Sot, ky Institut është vetëm hija e asaj që ishte dikur.

Të gjithë prodhuesit e mëparshëm të verërave kanë pasur marrëveshje me Institutin Bujqësor para luftës, sipas së cilave Instituti ishte përgjegjës për kryerjen e hulumtimit dhe vizitimin e vreshtave të tyre për të monitoruar dhe dokumentuar cilësinë e rrushit. Instituti pastaj mund të ofronte rekomandime mbi atë se kur do të duhej të vlej rrushi, praktikë që ka ndodhur vetëm një herë pas luftës (në Suharekë).¹⁰⁴ Tani, shënimet e rrudhura nga koha dhe librat kadastralë të të tetëdhjetave, kur edhe janë mbajtur për herë të fundit regjistrat mbi vreshtat, janë e tëra që mbesin, të shpërndara në dy tavolina të vjetra të zyrës së Ajdinit. Prej asaj kohe nuk janë mbajtur shënime të sakta, por vetëm vlerësime të përafërta.

Qeveria e Kosovës shpreson të adresojë këtë problem përmes miratimit të projektit trevjeçar të MBPZHR-së me vlerë prej 750,000, për themelimin e një kadastrit modern. Qeveria ka ndarë 350,000 Eurot e para në vitin 2008. Kadastrin tani ka përfunduar për komunën e Rahovecit, ndërsa procesi do të kryhet edhe në komuna tjera dhe Instituti i Verërave dhe Vreshtave në Rahovec do të marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë zyrtare për mirëmbajtjen e tij. Arsyet për zhvendosjen e kadastrit kryesisht kanë të bëjnë me përqendrimin e Institutit të Bujqësisë në bujqësinë në

¹⁰³ Intervistë e IKS-it me Shaban Ajdinin, 29 shkurt 2008.

¹⁰⁴ Intervistë e IKS-it me Shaban Ajdinin, 29 shkurt 2008.

përgjithësi, gjersa Instituti për Verëra dhe Vreshta në Rahovec është përgjegjës dhe i specializuar në vreshta dhe verari.

Aktualisht, Instituti Bujqësor vazhdon të operojë me Laboratorin e Enologjisë ku edhe kryhen të gjitha analizat kimike të verërave. Kjo më së shumti irriton prodhuesit e verës nga Rahoveci të cilët duhet të udhëtojnë mbi pesëdhjetë kilometra për në Pejë në mënyrë që t’ju analizohet vera dhe të marrin certifikatën. Duke marrë parasysh kërkesat gjithnjë e në rritje për eksport, Morina dhe stafi i tij, në vitin 2008, kërkuan financim për themelimin e një laborator modern enologjik në Rahovec, në mënyrë që analizat të mund të kryhen më afër prodhuesve të verës. “BE-ja kërkon që vlerësimi të kryhet në vendin e prodhimit,” shpjegon ai. Laboratori modern ka çmim prej afro 200,000 Euro dhe fondet ende nuk janë siguruar.

Edhe nëse Instituti në Rahovec do të merrte përsipër, apo ndante përgjegjësitë për analizat enologjike, Instituti Bujqësor në Pejë, po ashtu ka plane të veta për hulumtimin e specieve të reja të rrushit për prodhim në Kosovë. Prandaj, të dy institutet do të duhet të vazhdojnë bashkëpunimin e afërt.

Ku është Kosova?

Dokumenti i dytë problematik është EUR.1, i cili ia mundëson prodhuesit që të certifikojë prejardhjen e verës.¹⁰⁵ Prejardhja e një malli duhet të certifikohet në mënyrë që të merret norma e zgjedhur gjatë kalimit të doganës. Për një normë të tillë, duhet të dorëzohet formulari EUR.1 te autoritetet doganore. Çështja e parë dhe më e dukshme me dokumentin ka të bëjë problemin e njohjes së Kosovës; disa shtete nuk e njohin Kosovën si “shtet” të prejardhjes. “Verërat tona janë sikur verëra kopile, pa identitet,” thekson Bekim Hoxha nga Veraria Eko.¹⁰⁶ “Kjo e vështirëson tentimin për të eksportuar verë.” Veç kësaj, pa kadastër të verërave, nuk ka mënyrë zyrtare për të përcaktuar nëse një verë aktualisht ka prejardhje në Kosovë, dhe mbetet e paqartë nëse dokumenti duhet të lëshohet nga MTI apo OEK.

Dokumenti i tretë problematik nuk kërkohet nga shtetet anëtare të BE-së, mirëpo paraqet pengesë kur verërat lënë Kosovën. Në mënyrë që verërat të kalojnë kufirin, ato duhet të shoqërohen me certifikatën sanitare L03 të lëshuar nga “autoritetet kompetente” në pajtim me Kodin e Tarifave Doganore.¹⁰⁷ Megjithatë, kodi doganor nuk e përkufizon se kush është “autoriteti kompetent”. Madje, mbetet e panjohur nëse kodi zbatohet.

Gjithashtu, prodhuesit kanë shprehur shqetësime mbi barkodet.¹⁰⁸ Megjithatë, ideja që tregtia nga shteti në shtet kërkon barkod është gabim. Barkodet thjeshtë e lehtësojnë punën për blerësit siç janë supermarketet që të monitorojnë inventarët e tyre. Ndonëse barkodi tregon edhe shënimet se nga cili shtet vjen malli, ajo nuk është e domosdoshme për eksportim në një shtet anëtar të BE-

¹⁰⁵ Rregullorja e Komisionit Evropian nr. 1207/2001, 11 qershor 2001, publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian (L 165/1).

¹⁰⁶ Intervistë e IKS-it, 31 janar 2007.

¹⁰⁷ Intervistë e IKS-it me Zyrtarë Doganorë, prill 2009.

¹⁰⁸ Intervistë e IKS-it, 2007-2008.

së. Nëse barkodi është i domosdoshëm, kjo varet më tepër nga blerësi i fundit i verës i cili do të vendosë se a ta pranojë verën pa barkod. Oda Ekonomike e Kosovës lëshon barkode për të gjithë prodhuesit e Kosovës, por ky barkod nuk pranohet zyrtarisht nga institucionet e BE-së. Megjithatë, shumica e shteteve anëtare të BE-së janë në dijeni se produktet me barkode që fillojnë me numrin 390 janë prej Kosovës.¹⁰⁹

GROPAT NË RRUGËN PËR NË BRUKSEL

Është e qartë se Rahoveci ka potencial të madh për zhvillim të mëtutjeshëm të vitikulturës dhe vreshtarisë. Edhe fushat e tjera të Kosovës kanë potencial për prodhim të verës. Vreshta ka edhe në komunën e Prizrenit, Gjakovës, Suharekës, Malishevës dhe Pejës. Megjithatë, vreshtat në komunat e Suharekës dhe Gjakovës janë të zbehta krahasuar me vreshtat lulëzuese të Rahovecit. Për shembull, në qendër të Suharekës gjendet ndërmarrja e privatizuar NBI Suhareka, tani e njohur si Kosova Holding. Dikur verari ndërkombëtarësht e njohur që eksportonte për në Gjermani, Poloni, Francë, Slloveni dhe Serbi, ish punëtorët e saj frikësohen se kompania nuk do të mund të kthejë suksesin e mëhershëm të eksportimit prej afro gjashtë milionë litra në vit.¹¹⁰ Kompania italiane Fratinelli, e cila bleu bodrumin e vjetër të verërave e ka demoluar atë; pjesët e metalit do të shiten. Ekspertët italianë kanë analizuar tokën dhe kanë zbuluar se uji me bollëk në disa pjesë të tokës e bën atë më të përshtatshme për prodhimin e perimeve. Sipas Habib Usajt, Drejtor Komercial, do të ndërtohet një verari e re më e vogël në vend të saj, por ajo do të zhvendoset në fshatin Shirokë, disa kilometra nga Suhareka. Prej atëherë janë prerë disa pjesë të vreshtarisë që tash do të zëvendësohen me fruta dhe perime.¹¹¹

Ish drejtorët e NBI Suhareka, disa profesorë të bujqësisë dhe qytetarë të tjerë nuk u pajtuan me vendimin. Rreth 550 hektarë vreshta janë shkatërruar, posaçërisht afër rrugës kryesore.¹¹² “Është e qartë se ata dëshirojnë të bëjnë parcela për ndërtimin e banesave të reja apo të shesin tokën,” thanë ish drejtorët. Ata shprehën zhgënjimin e tyre me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës (AKP), e cila, thanë ata, asnjëherë nuk e ka monitoruar punën e pronarëve të ri, edhe pse veraria ishte shitur me spin-off special. Veç kësaj, sipas marrëveshjes, kompania është dashur të punësojë 450 punonjës, mirëpo ka punësuar vetëm 200 të ndarë në dy ndërrime prej 100 punonjësish të cilët punojnë individualisht 13 ditë në muaj. Ish drejtorët dhe punonjësit e NBI Suhareka kanë dërguar disa ankesa në qeveri, AKP dhe madje janë takuar me Kryeministrin në përpjekje për të ndaluar shkatërrimin e vreshtave në komunën e tyre, por ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim. “Vreshtat vazhdojnë të shkatërrohen madje kur rrushi i ri është në degë,” tha Sedat Kuqi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi.

“Shteti duhet të intervenojë me akte ligjore,” komenton Dr. Bashkim Korenica, profesor i vjetër në sektorin e vreshtave dhe prodhimin e verës në Fakultetin e Bujqësisë. “Ata duhet të bëjnë

¹⁰⁹ Intervistë e IKS-it me një zyrtar të Odës Ekonomike të Kosovës, korrik 2009.

¹¹⁰ Intervistë e IKS-it me ish punonjësit e NBI Suhareka, 27 mars 2008.

¹¹¹ Intervistë e IKS-it me Habib Usajn, Drejtor Komercial, Agrokosova holding (ish NBI Suhareka), 2 mars 2008.

¹¹² Intervistë e IKS-it me Sedat Kuqin, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, 5 qershor 2009.

plane urbane për fshatrat dhe qytetet para se të shkatërrohet e tërë toka bujqësore dhe vreshtat dhe të zëvendësohen me ndërtesa jologjore [dhe] pompa të benzinës. Duhet të zbatohen ligjet për tokën bujqësore dhe parcelizimin e tokës,” thekson ai. KLAN Kosova ka raportuar se Kosova humb mesatarisht dy mijë hektarë tokë bujqësore çdo vit.¹¹³ Veç kësaj, rreth 20,000 hektarë tokë bujqësore janë zhdukur prej vitit 1989.¹¹⁴ “Ekonomia do të prosperojë me fabrika, industri të ushqimit dhe bujqësi, jo me pompa të benzinës dhe pishina,” paralajmëron Korenica.

Më keq se NBI Suhareka është veraria Ereniku në komunën e Gjakovës, e cila tek duhet privatizuar. Veraria duhet sikur një orë e ndalur. Dy apo tre ish punonjës paraqiten pothuajse çdo ditë, duke shpresuar se do të kthehen në punë. Tani për tani, detyra e tyre e vetme është të shesin mbetjet e verërave nga kohët e mira të verarisë. Dikur verari e suksesshme në Krushë të Vogël, në komunën e Prizrenit, tani ajo ka fat të ngjashëm, duke mbetur në mëshirën e kohës, ende në pritje të privatizimit.

Është e qarë se kapaciteti i Kosovës për prodhim të verës mund të ketë të ardhme të ndritshme, por kjo është ngadalësuar nga disa pengesa në rrugë. “Është mëkat. Kjo nuk është dashur të na ndodhë,” tha Korenica. “Ne kemi potencial,” psherëtinë ai. “Ne vetëm duhet t’i organizojmë gjërat më mirë. ... Shteti duhet të intervenojë me kornizë ligjore dhe situata do të përmirësohet.”

Thirrje për të gjithë investitorët

Fatkeqësisht, komuna ofron pak ndihmesë për bujqit, përveç që i dëgjon nevojat, problemet dhe kërkesat e tyre.¹¹⁵ Gjithsej, buxheti për sektor të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural në vitin 2008 ishte më pak se pesë për qind e buxhetit të gjithmbarshëm komunal (€24,893 nga €5,056,179).¹¹⁶ Ky buxhet i imët ishte ndarë në pagesa dhe akumulim (€12,714) dhe mallra dhe shërbime (€12,179). Sektori kishte vetëm katër punonjës.

Në nivel shtetëror, MBPZHR ishte ministria me më së paku buxhet në Kosovë, duke pranuar vetëm 0.8 për qind të Buxhetit të Kosovës (BK) (€8,684,931) në vitin 2008. Buxheti është përmirësuar diç në vitin 2009, por ende është më pak se 1.1 për qind të BK-së (€12,161,791). Prandaj resurset e MBPZHR-së në përgjithësi dhe Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve dhe Prodhimit në veçanti ishin të pamjaftueshëm për investime direkte në sektorin e verërave.¹¹⁷

Gjersa mbështetja qeveritare ndaj industrisë bujqësore ka qenë e dobët, disa organizata ndërkombëtare u kanë ofruar asistencë fermerëve, duke përfshirë¹¹⁸ International Catholic Migration Commission (ICMC); Danish Peoples Help, Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, Agjencioni Evropian për Rindërtim, dhe Seïsscontact. Organizata franceze gjithashtu kanë dhënë

¹¹³ KLAN Kosova, 4 maj 2009, lajmet e orës 20:00.

¹¹⁴ MBPZHR, “Libri i Gjelbër i Kosovës: Strategji për zhvillim të qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë,” Prishtinë: maj 2003, f. 41.

¹¹⁵ Intervistë e IKS-it me Ibrahim Kryeziun, ish Shef Ekzekutiv, Rahovec, 5 shkurt 2008.

¹¹⁶ Buxheti i ndarë për shëndetësi (€562,156) dhe arsim (€2,592,550) ishte shumë më i lartë (2008 Buxheti për Rahovec, në dispozicion në: www.rahoveci-komuna.org, i qasur më 30 korrik 2008).

¹¹⁷ Intervistë e IKS-it me Nesim Morinë, Shef i Institutit të Verërave dhe Vreshtave në Rahovec, 28 mars 2008.

¹¹⁸ Intervistë e IKS-it me Avdullah Kryeziun, ish drejtor i Divizionit për Bujqësi pranë Kuvendit Komunal Rahovec, 15 janar 2008.

si donacion 32 serra në sipërfaqe prej 32 arësh për komunën e Rahovecit. Krahas furnizimeve dhe pajisjeve, organizatat ndërkombëtare kanë ofruar edhe trajnime profesionale dhe ngritje kapacitetesh në të gjitha sferat e bujqësisë, duke përfshirë edhe vreshta dhe pemishte.¹¹⁹ Në vitin 2002, UNDP-ja po ashtu ka financuar një projekt i cili është implementuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Agrikulturë (FAO) në bashkëpunim me Ministrinë, për të zhvilluar sektorin e verës në Kosovë.¹²⁰

Edhe pse familjet e Rahovecit kanë të afërm të cilët punojnë në diasporë dhe dërgojnë të holla në shtëpi, duket se shumë pak nga buxheti investohet në ekonomi. Nait Elshani, ish nën-kryetar i Komunës së Rahovecit, vajton faktin se shumë pak të hyra kanë shkuar në dobi të zhvillimit publik dhe ekonomik të rajonit. “Njerëzit tanë nuk investojnë në fabrika por në shtëpi” ka thënë ai.¹²¹

Momentalisht, ekonomia e Kosovës ka nevojë për infuzion, sipas zotit Elshani. “Njëjtë sikurse kur dikush është i sëmurë, dhe u duhet një shtytje.” Kreditë afat-gjate do të ishin ideale, dhe në qoftë se normat e interesit do të ishin më të ulëta, atëherë njerëzit do të ishin mëse të gatshëm të punonin më shumë. “Këta njerëz janë punëtorë të zellshëm, atyre u duhet vetëm pak ndihmë dhe një treg ku mund të shesin produktet e tyre.”

Po gjendja me femrat dhe verën?

E lidhur ngushtë me sfidat për krijimin e mundësive të reja në Kosovë drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik është edhe çështja se si të shfrytëzohet më së miri gjysma potenciale e forcës punëtore të Kosovës: femrat. Femrat fshatare shënojnë shifrat më të larta të papunësisë në Kosovë, si dhe shifrat më të ulëta të pjesëmarrjes aktive në forcën punëtore.¹²² Përfshirja e më shumë femrave fshatare në industrinë e verës mund të rrisë GDP-në e Kosovës, si dhe të kontribuojë në përmbushjen e OZhM-ve dhe Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). Gjithsesi, Banka Botërore e sheh “Barazinë Gjinore si Ekonomi e Mençur” dhe ndërlidh rritjen e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës me zhvillimin ekonomik më të shpejtë.¹²³

Vërehen disa femra të cilat punojnë në vreshtat e Rahovecit, por ato kalojnë shumicën e kohës duke kultivuar specat, domatet, patatet dhe perimet tjera. Në qytet, femrat punojnë si rregulluese flokësh, rrobaqepëse dhe shofere të taksive, falë trajnimit të ofruar nga organizata vendore jo-qeveritare ‘Hareja’.¹²⁴

¹¹⁹ *Po aty.*

¹²⁰ Intervistë e IKS-it me Nesim Morinën.

¹²¹ IKS intervistë, 28 janar 2008.

¹²² Republika e Kosovës, Ministria e Administratës Publike, Zyra Statistikore e Kosovës; <http://www.ks-gov.net/mpms/PDF-fajllat/Publikimet/Librat/2008-Raporti-Vjetor-Puna-dhe-Punesimi-PDF.aspx>

¹²³ Banka Botërore, “Barazia Gjinore si Ekonomi e Mençur: Plani i Veprimit Gjinor i Bankës Botërore (vitet fiskale 2007-10), Banka Botërore, shtator 2006, p. 2, në internet: <http://siteresources.worldbank.org/INTGENDER/Resources/GAPNov2.pdf>, shikuar më 3 qershor 2009.

¹²⁴ Intervistë e IKS-it me Fetah Berishën, Profesor i Gjuhës Shqipe dhe ish anëtar i Kuvendit të Kosovës, Rahovec, 28 qershor 2008. Një OJQ tjetër, Promocom, ka ofruar po ashtu trajnime për femrat në artizanat, rregullim flokësh, rrobaqepësi, si dhe kontabilitetit (Intervistë e IKS-it me Hidije Pistën dhe Blerta Nezaq, 1 shkurt 2008).

Në Stone Castle, 97.7 për qind nga gjithsej 262 punonjës ishin meshkuj në vitin 2008. Asnjë nga punonjësit në verarinë Haxhijaha nuk është femër. Vetëm disa nga meshkujt përmendnin kontributet e femrave të familjes në vreshtaritë familjare, duke cekur se ato kanë ndihmuar në mbushje dhe ambalazhim. Pse nuk ka më shumë femra të inkuadruara në industrinë e vreshtarisë në ekonominë rahoveciane gjithnjë në rritje? Në përgjithësi, arsyt duket të jenë kulturore.

Fjalët e urta mbi gratë dhe verën, në mesin e pronarëve dhe menaxherëve meshkuj në industrinë e vreshtarisë së Rahovecit, flitnin me bollëk. Për shembull, një i intervistuar deklaroi se vera cilësore ka tre veçori. Së pari, vera ka “shëndet të mirë” dhe është e “kthjellët si kristali”. Së dyti, trupit nuk ka aromë të huaj. Së treti, pas pirjes së gjysmë litre vere, nuk duhet të kemi kokëdhimbje. Megjithatë, shtoi ai, kjo po ashtu varet nga gjendja psikologjike e personit i cili pi. “Vera është si gruaja; nganjëherë duket e bukur, nganjëherë bajate.”

Ndokush mund të ngutet e të fajësojë këto të thëna të zakonshme në industrinë e vreshtarisë në Kosovë, në anën rurale dhe në mentalitetin “katunar” [zhargon urban i cili nënkupton “fshatarë të prapambetur”]. Duke përshkruar në hollësi procesin e kujdesit ndaj vreshtave, një tjetër fermer kishte ca fjalë proverbiale të tjera: “Vera është si fëmija dhe gruaja; ato kanë nevojë për shumë përkujdesje.” Gjersa ai dhe punonjësi i tij ishin të angazhuar kryesisht rreth prodhimit të verës, ai tha se gruaja e tij si dhe “nusja” tjetër punonin në vreshta dhe në paketim të shisheve.

Sidoqoftë, sipas fjalëve të Nazife Hundozit, Menaxhere e Zyrës së Personelit në Kuvendin Komunal të Rahovecit, numri i paktë i grave të punësuar në komunë nuk ishte pasojë e mentalitetit, por më tepër pasojë e mungesës së mundësive të punës.¹²⁵ Znj. Hundozi theksoi se shumë femra kishin diplomuar bashkë me të në Universitetin e Prishtinës para disa dekadash. Megjithatë, pak mundësi punësimi janë në dispozicion për këdo këto ditë, thotë ajo, si për femra ashtu edhe për meshkuj.

Në përpjekje për të ndihmuar gratë drejt përmirësimit të kushteve të jetesës, Kosova Enterprise Programme (KEP) në fillim të vitit 2007 ka filluar ofrimin e kredive speciale për femrat. Programi ofron kredi për femrat, deri në 60 muaj me norma interesi prej 1.3 për qind në muaj.¹²⁶ Për kredi bujqësore, normat e interesit ishin 1.25 për qind. Kompanitë e femrave nuk është e thënë të regjistroheshin akoma. Një numër femrash kanë marrë kredi, posaçërisht për artizanat por ndonjëherë edhe për bujqësi.

Edhe Kosinvest ka hapur zyre në qytetin e Rahovecit në (janar) të 2007-ës. Shumica e kredive janë dhënë në katër cikle. Fillimisht, duke filluar nga 500 € e gjer në 2000 € (periudha e maturimit 18 muaj) dhe me rritje graduale në kredi maksimale prej 5000 € (maturimi 36 muaj). Norma e interesit mujor është rreth 1.12 për qind.¹²⁷ Gjersa ata nuk kishin program enkas për femrat, sipas zyrtarit për kredi – femrat kanë marrë rreth 65 për qind të kredive nëpërmjet së

¹²⁵ IKS intervistë, 28 janar 2008.

¹²⁶ Intervistë e IKS-it me Artan Ejupin, Zyrtar për Kredi, KEP, 25 qershor 2007.

¹²⁷ Intervistë e IKS-it me Xhemë Krasniqin, Zyrtar për Kredi, Kosinvest, 25 qershor 2007.

paku një programi, shumica e të cilave kanë pasur destinim bujqësinë, blerjen e kafshëve, apo riparime shtëpiake. Kosinvest ka planifikuar të startojë program të ri të kredidhënies për shtëpiaket me norma më të ulëta prej 8-10 për qind, më të ulëta sesa programi fillestar prej 12-14 për qind.

Kreditë me interes të ulët kanë potencial që të ofrojnë stimulim për më shumë gra në mënyrë që ato të përfshihen në industri. Saktësisht, sipas Xhem Krasniqit, Zyrtar për Kredi pranë Kosinvestit “Gratë janë më të rregullta në kthim të kredisë sesa meshkujt.” Megjithatë, është fakt se bizneset e verës vazhdojnë të jenë të udhëhequra nga meshkujt. Madje, ka pasur raportime të ndryshme për meshkuj të cilët kanë marrë kredi në emër të grave të tyre me qëllim të përfitimit të normave më të mira.¹²⁸

Ndoshta, ajo që është më me rëndësi, femrave u nevojitet shkathtësim i ri në menaxhim financiar, marketing, kompjuter, gjuhë të huaja dhe shkathtësi tjera të nevojshme për udhëheqje biznesi dhe për nxjerrje të verës në tregje evropiane. Një kompani e zhvillimit të verës ka potencial të madh për punësim të stafit femëror të pa-shkathtësuar dhe të varfër, duke dhënë shkathtësitë bazë për prodhimtari si dhe industri të verës. Këtu ka hapësirë për Universitetin e Prishtinës që të ofrojë kurse profesionale në prodhim të verës, posaçërisht për femrat rurale.

LINJA EKSPRES RAHOVEC – BRUKSEL: UDHËRRËFYESI

Edhe pse rruga drejt Brukselit padyshim përshkohet me gropa, Rahoveci posedon pasurinë e resurseve dhe mundësitë unike për të shënuar rritje ekonomike. “Është mëkat që të lihet ky sektor [i verës] të na ikë prej duarsh,” komentonte Dr. Korenica. “Ne kemi potencial të madh për ta zhvilluar atë: klimën, tokën, diellin dhe popullatën e re.” Ata më me përvojë dhe ekspertët e kësaj fushe i kanë identifikuar një sërë hapash që duhet ndërmarrë për të përshpejtuar rrugëtimin e Kosovës drejt Brukselit.

Së pari dhe më me rëndësi, Qeveria e Kosovës duhet të tregojë përkushtim më të theksuar për zhvillimin e sektorit të bujqësisë duke e ngritur menjëherë buxhetin e gjithmbarshëm për ministrinë përkatëse. Më tej, Qeveria mund të përkrah zhvillimin e këtij sektori duke miratuar politika që u sjellin fermerëve përfitime, siç janë largimi apo së paku zvogëlimi i taksës së akcizës për mallra bujqësore, përshpejtimi i kohës së duhur për procedim të tatimit dhe ofrimi i subvencioneve për farë. Instituti për Verëra dhe Vreshtari në Rahovec në veçanti ka nevojë për resurse adekuate njerëzore dhe financiare në mënyrë që të mund të krijojë një regjistër funksional kadastral, të kryej analiza organoleptike, dhe të certifikohet nga BE, si hapa drejt eksportit në të ardhmen. Në këtë frymë, ligji i ri mbi verërat duhet të implementohet në tërësi dhe pa humbur kohë.

¹²⁸ Intervistë e IKS-it me Artan Ejupin, Zyrtar për Kredi, KEP, 25 qershor 2007.

E ardhmja e sektorit të verëtarisë në veçanti dhe e bujqësisë në përgjithësi duhet të mbrohet përmes zbatimit të ligjeve mbi tokën bujqësore dhe parcelizimin e tokave. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet krijimit të planeve urbane për fshatra dhe qytete, të cilat sigurojnë se toka bujqësore dhe vreshtat do të jenë të mbrojtura për shekuj të tërë.

Në nivel mikroekonomik, qeveria komunale duhet të përkrah më shumë familjet dhe veprimtaritë kultivuese të rrushit, në mënyrë që të krijohen ngastrat bujqësore në të cilat kultivohen fidane të ndryshme, përfshirë varietetet që janë të provuara dhe të suksesshme në Kosovë por edhe varietete në baza eksperimentale, duke u bazuar në kërkesën e tregut botëror. Prodhuesit tjerë të Kosovës më pas do të kenë mundësi që t'i vizitojnë këto ngastra dhe të mësojnë më shumë mbi kultivimin e varieteteve të reja. Aktualisht, fidane po mbillen nga një numër i vogël familjesh në Kosovë, ndërsa që prodhuesit e verës po shfrytëzojnë fidane nga Serbia që as nuk janë të verifikuara e as të kontrolluara. Zhvillimi dhe rritja e kontrolluar e fidaneve të cilësisë së lartë, eventualisht do t'i ndihmon Kosovës në përmbushjen e kërkesës botërore dhe do të përshpejton qasjen në tregjet më të gjera.

Prodhuesit e verës gjithashtu mund të ndërmarrin hapa për të përshpejtuar rrugëtimin e Kosovës drejt Brukselit. Fermerët privatë mund të përfitojnë nga krijimi i kooperativave bujqësore ku do të shfrytëzohin bashkërisht pajisjet dhe teknologjinë. Përpunimi i rrushit, prodhimi i verës, marketingu dhe shitja do të paraqisnin veprimtari të përbashkëta nga të cilat do të përfitonin të gjithë anëtarët e kooperativës. Do të mund të krijoheshin Shoqatë e Verërave dhe Vreshtave, që do përfshinte në anëtarësinë e vet ekspertë të ndryshëm të verërave dhe vreshtave dhe do të bazohej në praktikën më të mirë të Shoqatës së Anadrinit, e cila do të mund t'i edukonte fermerët mbi kultivimin e vreshtave, shfrytëzimin e pesticideve dhe mbi varietetet që aktualisht kërkohen anëmbanë botës në tregjet ndërkombëtare.

Konkurrueshmëria e Kosovës në tregjet botërore mund të zhvillohet më tej me përmirësime të realizuara në paketim dhe marketing. Investuesit, përfshirë edhe ndërmarrjet nga BE apo donatorët relevantë të interesuar për zhvillimin ekonomik të Kosovës mund të shohin rezultate të shpejta nga bashkëpunimi me prodhues të suksesshëm vendorë. Më specifiku, prodhuesit e verës në Kosovë kanë nevojë për përkrahje në krijimin e brendeve, në marketing për konsumim në vende të ndryshme dhe në promovim të produkteve në aspekt ndërkombëtar. Edhe në këtë rast, Qeveria e Kosovës ka një rol të rëndësishëm për të përshpejtuar progresin duke avokuar tek shtetet evropiane për lehtësime të vizave në mënyrë që prodhuesit të mund të udhëtojnë jashtë vendit lirshëm për t'u takuar me klientë potencialë dhe për të krijuar marrëdhënie afariste me ta.

Me një përkushtim të fuqishëm nga qeveria qendrore dhe nga qeveritë lokale dhe me ndihmë teknike e financiare nga Komisioni Evropian – duke qenë se bujqësia paraqet një nga fushat e procesit të integritit në Bashkimin Evropian – rruga drejt Brukselit mund të mos jetë edhe aq e gjatë. Së bashku ne mund të bëjmë që rrushi ynë i bardhë e i kuq të konkurrojnë në tregun evropian brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore.

PËR NE

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është *think-tank* i pavarur dhe joprofitabil i cili përqëndrohet në hulumtime empirike dhe analiza të zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. E themeluar në vitin 2004, IKS ofron hulumtime inovative dhe politika relevante me synim që të nxis debate për çështjet e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës.

Ne besojmë që debatet publike të bazuara në dëshmi janë thelbi i vendimmarrjes demokratike.

Që nga vera e vitit 2004, IKS ka zgjeruar stafin dhe sot përfshin shtatë analistë dhe hulumtues me orar të plotë, dhe rrjet në rritje e sipër të hulumtuesve dhe bashkëpunëtorëve. IKS përkrahet në punën e saj nga Bordi Këshillues i përbërë nga analistë dhe praktikantë Kosovarë dhe ndërkombëtarë.

Që nga zanafilla e saj, puna IKS është përqendruar në çështjet e qeverisjes, zhvillimit ekonomik, planifikimit urban, korrupsionit në rindërtimin e pas-luftës, mbrojtjen e ambientit, arsimit, problemit të imazhit të Kosovës si dhe strukturat qeverisëse ngatërruese të tanishme. IKS është poashtu pjesë e rrjetit të *think-tanks* në mbarë Evropën Juglindore të inspiruar nga ESI si dhe anëtare e ECAS-it.

Të gjitha raportet tona mund ti gjeni në faqen tone të internetit.